

PLANI ZHVILLIMOR I KOMUNËS SË VUSHTRISË

RAPORT VLERËSIMI

Mars 2020



PLANI ZHVILLIMOR I KOMUNËS SË VUSHTRISË

RAPORT VLERËSIMI

mars 2020

Të gjitha të drejtat e rezervuara © 2020

Komuna e Vushtrrisë
Rr. "Isa Boletini" nr.10, 42000 Vushtrri, Kosovë <https://kk.rks-gov.net/vushtrri/>

Programi i Kombeve të Bashkuara për Vendbanime Njerëzore (UN-Habitat)
Ndërtesa e Ministrive "Rilindja," kati i 10-të, 10000 Prishtinë, Kosovë
www.unhabitat.org
www.unhabitat-kosovo.org

Fotografitë, hartat dhe diagramet mund të riprodhohen nëse printohet edhe burimi.

FALENDERIME

Falenderojmë Komunën e Vushtrrisë për kontributin e dhënë gjatë procesit të vlerësimit, veçanërisht Drejtorin e Urbanizmit dhe Mbrojtjes së Mjedisit, z. Berat Sadiku dhe stafin e tij, Ekipin Komunal të Planifikimit (EKP), Komitetin Drejtues (KD), përfaqësuesit e shoqërisë civile dhe kompanive publike rajonale.

AUTORE E RAPORTIT

Alma Paçarizi

REDAKTIMI

Besnike Koçani

Gwendoline Mennetrier

FACILITATORËT KRYESORË

Besnike Koçani

Sami Stagova

KONTRIBUESIT TJERË

Zana Sokoli

Avni Alidemaj

Arta Bytyqi

Adem Llabjani (Logistics)

MBËSHTETËS

Vjollca Puka, MMPH

Merita Dalipi, MMPH

Arbën Rrecaj, MMPH

PËRMBAJTJA

Lista e akronimeve
Lista e tabelave
Lista e diagrameve
Lista e figurave

KAPITULLI 01

Hyrje

Bashkëpunimi ndërmjet Komunës së Vushtrrisë dhe UN-Habitat
Korniza Ligjore
Plani Zhvillimor Komunal drejt Hartës Zonale të Komunës

KAPITULLI 02

Qëllimi i vlerësimit dhe Metodologjia

Korniza e Vlerësimit të Qëndrueshmërisë

Vlerësimi i PZHK-së në bazë të kërkesave ligjore (të dhënat e nevojshme për HZK)

KAPITULLI 03

Përmbledhje e punëtorisë së vlerësimit

Sesioni i parë: Nga Plani Zhvillimor Komunal drejt Hartës Zonale të Komunës
Sesioni i dytë: Mjetet e vlerësimit

KAPITULLI 04

Të gjeturat

Krahasimi i të gjeturave nga të dyja vlerësimet

KAPITULLI 05

Përfundimet dhe rekomandimet

ANEKS A

ANEKS B

ANEKS C

ANEKS D

LISTA E AKRONIMEVE

KD - Komiteti Drejtues
EKP - Ekipi Komunal i Planifikimit
PZHK - Plani Zhvillimor Komunal
HZK - Harta Zonale e Komunës
MMPH - Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor
IPH - Instituti për Planifikim Hapësinor
UN-Habitat - Programi i Kombeve të Bashkuara për Vendbanime Njerëzore
DUMM - Drejtoria për Urbanizëm dhe Mbrojtje të Mjedisit
DGJKP - Drejtoria për Gjeodezi, Kadastër dhe Pronë
VSM - Vlerësimi Strategjik Mjedisor
AK - Asambleja Komunale
UA - Udhëzimi Administrativ

LISTA E TABELAVE

Tabela 1: Paraqitja skematike e përmbajtjes së tabelës për Kornizën për Vlerësimin e Qëndrueshmërisë

Tabela 2: Paraqitja skematike e përmbajtjes së tabelës për të dhënat komunale

Tabela 3: Vlerësimi i qëndrueshmërisë për të gjitha fushat tematike dhe rezultatet (përfshirë grafikun)

LISTA E DIAGRAMEVE

- Diagrami 1. Rezultatet e qëndrueshmërisë për fushën tematike Planifikimi Urban dhe i Tokës
- Diagrami 2. Rezultatet e qëndrueshmërisë për fushën tematike Hapësira Publike
- Diagrami 3: Rezultatet e qëndrueshmërisë për fushën tematike Parcelat dhe Bllloqet
- Diagrami 4: Rezultatet e qëndrueshmërisë për fushën tematike Të Drejtat Zhvillimore
- Diagrami 5: Rezultatet e qëndrueshmërisë për fushën tematike Kodi i Ndërtimit
- Diagrami 6: Rezultatet e qëndrueshmërisë për fushën tematike Financat e bazuara në Tokë
- Diagrami 7: Disponueshmëria e të dhënave për strukturën dhe Infrastrukturën Ekonomike (sipërfaqet) të PZHK-së
- Diagrami 8: Disponueshmëria e të dhënave për Vendbanimet dhe Infrastrukturën e Banimit (sipërfaqet dhe objektet)
- Diagrami 9. Disponueshmëria e të dhënave për Demografinë, Infrastrukturën Ekonomike (ndërmarrjet) dhe Buxhetin
- Diagrami 10. Disponueshmëria e të dhënave për Infrastrukturën dhe Shërbimet Publike
- Diagrami 11. Disponueshmëria e të dhënave për Infrastrukturën dhe Shërbimet Teknike
- Diagrami 12: Disponueshmëria e të dhënave për Infrastrukturën e Transportit Publik
- Diagrami 13: Disponueshmëria e të dhënave për Trashëgiminë Kulturore/Natyrore dhe Mjedisin
- Diagrami 14: Rezultatet e krahasimit për të gjitha fushat tematike - Korniza e Vlerësimit të Qëndrueshmërisë
- Diagrami 15: Krahasimi i disponueshmërisë së të dhënave të PZHK për të gjitha fushat tematike

LISTA E FIGURAVE

- Figura 1. Harta e Komunës së Vushtrrisë
- Figura 2 /3. Raporti i Vlerësimit Bazë dhe Plani Zhvillimor Komunal (PZHK) (© UN-Habitat dhe Komuna e Vushtrrisë)
- Figura 4. Korniza për Vlerësimin e Qëndrueshmërisë (Ligjit të Planifikimit) (©UN-Habitat)

KAPITULLI

01



Hyrje

Komuna e Vushtrrisë shtrihet në rajonin verior të Kosovës dhe përfshinë një zonë prej 345 km² (3.2% e territorit të Kosovës), të ndarë në 64 zona kadastrale (sipas vendimit për HZK-në janë 65)¹. Ajo kufizohet me Mitrovicën Jugore (veri), Podujevën (lindje), Obiliqin (jug), Drenasin (jugperëndim) dhe Skënderajin (perëndim). Popullsia e gjithë territorit të komunës është vlerësuar të jetë 104.000 banorë; prej tyre, mbi 39.800 banorë në zonën urbane dhe rreth 64.200 banorë në zonën rurale. Etnitë kryesore janë Shqiptarët (92%), Serbë e Malazezë (7%) dhe të tjerë (1%).

Relievi i komunës ndahet në tri tërësi: fushore, kodrinore dhe malore; ato janë pjesë përbërëse e masës malore të Kopaonikut dhe Qyqavicës. Sa i përket rrjetit hidrografik, nëpër territor kalon Sitnica (2912 km²) me disa degë të saj dhe një pjesë e lumit Llap, si dhe dy lumenjë më të vegjël, Tërstena dhe Studimja. Komuna karakterizohet me klimë të butë, kontinentale-mesdhetare dhe kontinentale evropiane.

¹ Sipas dokumenteve zyrtare të dërguara me datën 07.06.2018 nga Agjencia Kadastrale e Kosovës (shih dokumentin e bashkangjitur), në të gjitha sistemet duke filluar prej viteve 1983-1988 e deri më tani, zona kadastrale Dumnicë e Epërme ka ekzistuar dhe ekziston si zonë kadastrale, ka kodin unik të zonës kadastrale 70202019, në kuadër të territorit të komunës së Vushtrrisë. Mirëpo gjatë hartimit të Ligjit për Kufijtë Administrativ të Komunave fshati Dumnicë e Epërme është harruar të futet në listë. Në momentin kur fillon procesi i plotësimit/ndryshimit të këtij ligji, komuna e Vushtrrisë do të paraqesë kërkesën zyrtare pranë ministrisë përkatëse për inkooprimin e këtij fshati (Dumnicë e Epërme) në kuadër të listës.





Sipërfaqja: 345 km²
Popullsia: 104.000 (Census2011)
Popullsia sipas etnisë:

Shqiptarë: 92%

Serbo-malazez: 7%

Të tjerë: 1%



LEGJENDA:

- KUFIRI I KOMUNËS
- ZONË PYJORE
- VENDBANIMET SIPAS NUMRIT TË BANORËVE
- ZONAT KADASTRALE
- RRJETI I LUMENJËVE
- RRJETI RRUGOR/HEKURUDHOR

Figura 1. Harta e Komunës së Vushtrisë

UN-Habitat ka ndihmuar në mënyrë aktive institucionet e Kosovës në fushën e qeverisjes, planifikimit hapësinor dhe administratës komunale që nga viti 1999. Duke u mbështetur në rezultatet dhe mjetet e krijuara nga Programi i Mbështetjes së Planifikimit Hapësinor Komunal (zbatuar nga 2005 deri në 2016), UN-Habitat tani zbaton Programin e Zhvillimit Gjithëpërfshirës (2016-20), i cili synon të sigurojë mbështetje strategjike, gjithëpërfshirëse për ndërtimin e kapaciteteve të planifikimit dhe menaxhimit komunal, forcimin e kontratës shoqërore dhe kohezionin social, dhe forcimin e koordinimit brenda një kornize të bashkëpunimit ndër-komunal dhe qeverisje shumë-niveloze me qëllim të nxitjes së zhvillimit gjithëpërfshirës dhe qeverisjes së mirë në veri të Kosovës. Programi është financuar nga Agjencia Suedeze për Zhvillim Ndërkombëtar dhe zbatohet bashkarisht me PAX dhe Community Building Mitrovica (CBM).

Me reformën e re ligjore mbi planifikimin hapësinor dalin kërkesa të reja ligjore, siç është hartimi i Hartës Zonale të Komunës (HZK). Si e tillë, Komuna e Vushtrrisë filloi procesin duke e shprehur interesin për të punuar me UN-Habitat në hartimin e Hartës Zonale të Komunës. Si rezultat, UN-Habitati përmes një vlerësimi bazë² ka analizuar në mënyrë shumë të detajuar kapacitetet ekzistuese profesionale dhe teknike që ndërlidhen me proceset dhe produktet e planifikimit hapësinor brenda kësaj komune. Ky vlerësim ka nxjerrë në pah tri prioritet kryesorë të kësaj komune: 1) Vlerësimi i Planit Zhvillimor Komunal (PZHK) në funksion të hartimit të Hartës Zonale të Komunës, 2) Krijimi i Bazës së të Dhënave të Planifikimit Hapësinor, dhe 3) Hartimi i Hartës Zonale të Komunës së Vushtrrisë. Planifikimi dhe zbatimi i të gjitha këtyre aktiviteteve koordinohet nga afër me Drejtorinë për Urbanizëm dhe Mbrojtje të Mjedisit, si autoritet komunal përgjegjës për planifikim dhe menaxhim hapësinor.

Vlerësimi i Planit Zhvillimor Komunal të Komunës së Vushtrrisë të hartuar në 2016 është aktiviteti/prioriteti i parë që po zbatohet me qëllim të vlerësimit të përputhshmërisë ligjore të PZHK-së ekzistuese me kornizën përkatëse të planifikimit hapësinor. Përmes mjeteve përkatëse të vlerësimit do të identifikohen të gjitha të dhënat që mungojnë dhe janë të nevojshme për ndërtimin e të Bazës së të Dhënave të Planifikimit Hapësinor (niveli lokal)³, respektivisht hartimin e Hartës Zonale të Komunës.

Vlerësimi i PZHK-së së Vushtrrisë bazohet në disa kërkesa ligjore që mbështesin proceset relevante të planifikimit hapësinor dhe janë aprovuar nga Qeveria e Kosovës, respektivisht Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor (MMPH).

Si fillim, korniza e planifikimit hapësinor në Kosovë përcaktohet me Ligjin nr. 04/L-17 për Planifikimin Hapësinor, të miratuar në vitin 2013. Sipas nenit 5, paragrafi 1 (1.2) i këtij ligji, autoriteti përgjegjës për planifikim hapësinor i nivelit lokal, në këtë rast Drejtoria e Urbanizmit dhe Mbrojtjes së Mjedisit, obligohet të hartojë Planin Zhvillimor Komunal. Bazuar në këtë nen, Kuvendi Komunal i Vushtrrisë në qershor të vitit 2016 ka miratuar Planin Zhvillimor Komunal 2016 - 2024, përfshirë edhe Raportin e Vlerësimit Strategjik Mjedisor. Dokumente tjera të rëndësishme që janë marrë parasysh gjatë vlerësimit janë: (1) UA nr. 11/2015 për Pjesët dhe Kërkesat Themelore për Hartimin, Zbatimin dhe Monitorimin e Planit Zhvillimor Komunal, 2) UA nr. 24/2015 mbi Elementet dhe kërkesat themelore për hartimin, zbatimin dhe monitorimin e Hartës Zonale të Komunës, dhe 3) UA nr. 03/2019 për Mirëmbajtjen e Bazës së të Dhënave dhe obligimet e autoriteteve publike dhe personave tjerë fizik dhe juridik për mirëmbajtjen dhe dorëzimin e dokumenteve dhe të dhënave në bazën e të dhënave.

Nga Plani Zhvillimor Komunal drejt Hartës Zonale të Komunës

Plani Zhvillimor i Komunës së Vushtrrisë është dokument multisektorial që përcakton qëllimet afatgjata të zhvillimit ekonomik, social dhe hapësinor. Ky dokument i hartuar në vitin 2016 dhe i vlefshëm deri në vitin 2024 përfshinë planin për zhvillimin e zonave urbane dhe rurale për një periudhë prej së paku 8 vitesh. Në ligjin e ri të planifikimit hapësinor prezantohet Harta Zonale e Komunës (HZK) – dokument multi-sektorial që përmes grafikoneve, hartave dhe tekstit përcakton hollësisht llojin, destinimin, shfrytëzimin e planifikuar të hapësirës dhe masat e veprimit të cilat bazohen në kohëzgjatje dhe projeksione të arritshme të investimeve publike dhe private për tërë territorin e Kosovës, për një periudhë së paku tetë (8) vjeçare – si faza e radhës e zhvillimit hapësinor.




Figura 2 & 3.
Raporti i Vlerësimit Bazë dhe Plani Zhvillimor Komunal (PZHK)

(© UN-Habitat dhe Komuna e Vushtrrisë)

² https://unhabitat-kosovo.org/un_habitat_documents/baseline-assessment-report/

³ Kjo databazë do të jetë kompatible me Bazën e të Dhënave të Planifikimit Hapësinor në nivel qendror (CSPD/SPAK).

KAPITULLI

02

Qëllimi i vlerësimit dhe Metodologjia

Vlerësimi ka për qëllim mbështetjen e Komunës së Vushtrrisë në vlerësimin e përpunueshmërisë ligjore të Planit Zhvillimor Komunal (PZHK-së) si hap i parë drejt nisjes së procesit të hartimit të Hartës Zonale të Komunës (HZK-së); gjithashtu informon stafin komunal rreth mjeteve të vlerësimit të PZHK-së që përdoren gjatë realizimit të këtij procesi. Për këtë arsye, të gjithë akterët relevantë (Komuna e Vushtrrisë, kompanitë publike rajonale, shoqëria civile, MMPH dhe UN-Habitat) janë mbledhur së bashku për të vlerësuar qëndrueshmërinë e procesit të planifikimit nëpërmjet disa fushave ndërdisiplinore dhe për të identifikuar të dhënat që mungojnë e që janë të nevojshme për hartimin e HZK-së. Dy metodologjitë kryesore të vlerësimit të PZHK-së së Vushtrrisë janë:

I. Korniza për Vlerësimin e Qëndrueshmërisë

II. Vlerësimi i PZHK-së në bazë të kërkesave ligjore (të dhënat e nevojshme për HZK)

Korniza për Vlerësimin e Qëndrueshmërisë (e njohur si Korniza për Vlerësimin e Ligjit të Planifikimit dhe e zhvilluar nga Njësia për Legjilsacion Urban e UN-Habitat) përdoret si mjet i shpejtë për vetëvlerësimin e reformave ligjore, përkatësisht identifikimin e përparësive dhe dobësive të proceseve të planifikimit hapësinor në bazë të ligjeve dhe rregulloreve relevante që vlejné në një qytet. Fushat e planifikimit të identifikuar janë: planifikimi urban dhe i tokës, hapësira publike, parcelat dhe blloqet, të drejtat zhvillimore, kodi i ndërtimit dhe financat e bazuara në tokë. Të gjitha këto fusha vlerësohen duke u bazuar në dy tregues kryesorë, efektiviteti legjislativ funksional dhe aspektet teknike, të cilat zërthehen në pesë skenarë të ndryshëm, nga më i keqi (0) te më i miri (4). Treguesi i parë i përbërë nga 5 nën-tregues trajton mbarëvajtjen e procesit dhe mekanizmave të tij, organizimin dhe rolin institucional, standardet hartuese dhe kapacitetet zbatuese. Treguesi i dytë trajton aspektet teknike të secilës fushë tematike (1-6) prandaj nën-treguesit dallojnë nga njëri tjetri si pasojë e definimit në bazë të kriterëve të fushës relevante. Me mbledhjen e pikëve totale (deri në 40/treguesit dhe 20/nën-treguesit) nxirren rezultatet përfundimtare për 6 fushat tematike të identifikuar; për më tepër, rezultatet janë të ilustruara edhe në grafikone.




Figura 4. Korniza për Vlerësimin e Qëndrueshmërisë (Ligjit të Planifikimit) (©UN-Habitat)

Tabela 1. Paraqitja skematike e përmbajtjes së tabelës për Kornizën për Vlerësimin e Qëndrueshmërisë

FUSHA TEMATIKE			
Treguesit	Nën-treguesit	Rankimi 0 deri 4	Pikët
Efektiviteti funksional legjislativ	1 deri 5		
Aspektet teknike	1 deri 5		

Metoda e dytë e vlerësimit përdoret për vlerësimin e përputhshmërisë së PZHK-së me kornizën ligjore për planifikimin hapësinor, përfshirë të dhënat e PZHK-së, në bazë të të cilave është bërë analiza hapësinore dhe planifikimi i nevojshëm. Për të aplikuar këtë metodë, është shqyrtuar korniza ligjore për planifikim hapësinor, nga e cila është përpiluar një listë e të gjitha të dhënave të nevojshme për hartimin e HZK. Lista (Aneks A) ka qenë referenca kryesore në bazë të së cilës janë zhvilluar këto mjete të vlerësimit. Rezultatet kryesore të kësaj metodologjie janë fituar nëpërmjet analizave nga afër të: (1) Strukturës/përmbajtjes së PZHK-së (pjesa tekstuale dhe hartografike) – për t'i përmbytur kërkesat ligjore, (2) Të dhënat (tabelat) komunale – për të analizuar gjendjen aktuale në komunë.

Vlerësimi i të dhënave, sipas përmbajtjes së tabelës, është bërë në dy sesione: (1) Vlerësimi i të dhënave të profilit të PZHK-së, dhe (2) Vlerësimi i zhvillimit të planifikuar të PZHK-së. Fushat tematike në këtë metodë janë:

1. Struktura e PZHK + Infrastruktura Teknike/ sipërfaqet
2. Vendbanimet + Infrastruktura e banimit
3. Demografia + Infrastruktura Ekonomike/Ndërmarrjet + Buxheti
4. Infrastruktura dhe Shërbimet Sociale/Publike
5. Infrastruktura dhe Shërbimet Teknike
6. Infrastruktura e Transportit Publik
7. Trashëgimia Kulturore dhe Natyrore + Mjedisi

Tabela 2. Paraqitja skematike e përmbajtjes së tabelës për të dhënat komunale

FUSHA TEMATIKE	PROFILI	KONCEPTI ZHVILLIMOR
	Lloji i të dhënave	Lloji i të dhënave
SEKTORËT SIPAS FUSHËS	Të dhënat e profilit të PZHK-së	Të dhënat e konceptit zhvillimor të PZHK-së

Skemat janë ilustrim i të dhënave komunale të kërkuara (sipas radhitjes tabelare) për të dyja metodologjirë, bazuar në tabelat përkatëse të mjeteve të vlerësimit (shiko Aneks B, C).

KAPITULLI

03



Përmbledhje e punëtorisë së vlerësimit

Në javën e fundit të qershorit të vitit 2018, Komuna e Vushtrrisë, mbështetur nga zyra e UN-Habitat-it në Kosovë, ka mbajtur një punëtori 3-ditore në Manastir (Parku Kombëtar i Pelisterit), Maqedoni e Veriut. Qëllimi kryesor i kësaj punëtorie ishte Vlerësimi i Planit Zhvillimor Komunal (PZHK, 2016-2024) të Vushtrrisë, ku tregohet përputhshmëria ligjore dhe konceptuale e dokumentit të PZHK-së si hap i parë drejt nisjes së procesit të hartimit të Hartës Zonale të Komunës (HZK). Kjo punëtori gjithashtu kishte për qëllim edhe:

- koordinimin mes stafit të Komunës së Vushtrrisë, kompanive publike rajonale, shoqërisë civile dhe MMPH-së për t'u njohur me Planin e Integruar të Punës 2018-2020, përkatësisht me aktivitetet e menjëherëshme që janë përgjegjësi e tyre;
- familjarizimin e stafit me dallimet dhe ndërlidhjen mes Planit Zhvillimor Komunal (PZHK) dhe Hartës Zonale Komunale (HZK);
- dhënien e udhëzimeve për përdorimin e mjeteve të Kornizës për Vlerësimin e Qëndrueshmërisë dhe mjeteve për Vlerësimin e PZHK;
- identifikimin e të dhënave që mungojnë (përmes vlerësimit të PZHK-së aktuale të Vushtrrisë) e që janë të nevojshme për hartimin e HZK si dhe, trajtimin e çështjes se kur dhe si do të mbledhen ato;
- njoftimin me hapat e ardhshëm që duhet ndërmarrë në periudhën e ardhshme në lidhje me procesin e hartimit të HZK-së si dhe, rolin e akterëve relevantë.

Rreth 32 zyrtarë (staf komunal nga departamente të ndryshme dhe përfaqësues të shoqërisë civile) morën pjesë në arritjen e objektivave të kësaj punëtorie, duke përfshirë gjithashtu përfaqësues nga Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor (MMPH) dhe UN-Habitat.

Përfaqësuesit e UN-Habitatit në Kosovë, znj. Besnike Kocani dhe z. Sami Stagova në cilësinë e Këshilltarëve për Planifikim Hapësinor dhe Urban, kanë dhënë fjalimet hyrëse duke iu shprehur pjesëmarrësve mirëseardhje dhe duke shpjeguar qëllimin e punëtorisë. Fjala iu dha edhe z. Berat Sadiku, Drejtorit të Urbanizmit dhe Mbrojtjes së Mjedisit në Komunën e Vushtrrisë i cili shkurtimisht theksoi rëndësinë dhe ndikimin e procesit në baza komunale. Poashtu, znj. Vjollca Puka, z. Arbën Rrecaj dhe Znj. Merita Dalipi, përfaqësues nga MMPH përgëzuan për iniciativën dhe thanë se vlerësimi i PZHK-së është një hap i duhur drejt fillimit të procesit të hartimit të HZK-së. Pas sesioneve të ndryshme me grupet punuese, palët u dakorduan që të hartohet raporti i vlerësimit si një nga produktet fillestare të këtij procesi, si dhe u diskutuan hapat e radhës lidhur me Hartën Zonale të Komunës.

Sesioni i parë: Nga Plani Zhvillimor Komunal drejt Hartës Zonale të Komunës

Punëtorja është realizuar duke përdorur metoda dhe teknika të ndryshme duke filluar nga sesionet prezantuese dhe diskutimet e deri tek grupet punuese. Fillimisht, pjesëmarrësit janë njoftuar me komponentët e Programit për Zhvillim Gjithëpërfshirës, përkatësisht kalimin nga PZHK tek HZK, duke vazhduar me aspektet dhe mjetet e vlerësimit, dhe ndërlidhjen e databazës së planifikimit hapësinor me HZK. Më pas, përfaqësuesja e Divizionit për Planifikim Hapësinor nga MMPH-ja prezantoi kornizën ligjore të PZHK-së dhe HZK-së dhe shpjegoi hapat kryesorë të procesit të planifikimit siç janë hartimi, shqyrtimi publik, miratimi, etj. Sesioni përfundoi me një prezantim nga përfaqësues të UN-Habitat në lidhje me metodat e vlerësimit: (1) Korniza e Vlerësimit të Qëndrueshmërisë dhe (2) Vlerësimi i bazuar në kërkesat ligjore (të dhënat e nevojshme për HZK)

Sesioni i dytë: Mjetet e vlerësimit

I. Korniza e Vlerësimit të Qëndrueshmërisë

Pjesëmarrësit janë ndarë në 7 grupe për të realizuar detyrën nëpërmjet diskutimeve grupore dhe prezantimeve interaktive të rezultateve përfundimtare, përfshirë grafikonet e ilustruar në fund të sesionit. Puna është ndarë në dy sesione ku fillimisht grupet hartuan një përkufizim për secilën fushë tematike dhe identifikuan përparësitë, dobësitë dhe aktivitetet e nevojshme (sipas kërkesave komunale). Në pjesën e dyte, secili grup duhej t'i vlerësonte treguesit për secilën fushë tematike duke përdorur skenarët nga më i dobëti (0) deri te më i miri (4), gjë që shfaq nivelin e arritjes së qëndrueshmërisë. Gjetjet u prezantuan në fund të sesionit me grafikone që po ashtu shfaqin krahasime ndërmjet secilës fushë tematike. Më poshtë prezantohen rezultatet e nxjerra nga ky sesion sipas gjetjeve të secilit grup; për sqarime të mëtejshme referohemi tek Kapitulli 4 (Të gjeturat).



Grupi 1: Planifikimi Urban dhe i Tokës

Definicioni sipas Kornizës për Vlerësimin e Qëndrueshmërisë:

Menaxhimi i tokës është procesi i përdorimit efikas të burimeve të tokës. Sistemet efektive të administrimit të tokës synojnë sigurinë e pronësisë, një bazë për vlerësimin e tokës, pronësi dhe taksimin, përmirësimin e qasjes në investime, përdorim të qëndrueshëm të tokës dhe minimizimin e konflikteve të tokës.

Definicioni sipas grupit punues:

Ndarja e hapësirës urbane në zona sipas destinimit, shfrytëzimit, kushteve zhvillimore dhe ndërtimore.

Të gjeturat & Rezultatet:

Përparësitë

Legjislacioni i kompletuar;
PZHK;

Qasja online në pronë – AKK;
Vetëdijësimi i qytetarëve;

Rritja e barazisë gjinore në pronësi.

Mangësitë

Mungesa e stafit të mjaftueshëm;

Mungesa e zbatimit të duhur të planeve;

Mangësi në dokumente të planifikimit hapësinor;
Mosefikasiteti i nevojshëm i inspektoratit në terren.

Veprimet

Rritja e nr. të profesionistëve të fushës përmes shkollimit, trajnimeve brenda dhe jashtë vendit (urbanizëm, inspektorat, gjeodezi);

Forcimi i mekanizmit që mundëson zbatimin korrekt të planeve (inspektimet);

Rritja e numrit të inspektorëve.

	Aspektet teknike	15
Vlerësimi sipas treguesve (nga 20)	Efektiviteti funksional legjislativ	15
Vlerësimi gjeneral (nga 40)		30

Vlerësimi sipas treguesve

● Aspektet teknike ● Efektiviteti funksional legjislativ



Diagrami 1. Rezultatet e qëndrueshmërisë për fushën tematike Planifikimi Urban dhe i Tokës

Grupi 2: Hapësira Publike

Definicioni sipas Kornizës për Vlerësimin e Qëndrueshmërisë:

Karta e Hapësirës Publike përcakton hapësirën publike si “të gjitha vendet në pronësi publike ose përdorim publik, të qasura dhe të shfrytëzuara nga të gjithë falas dhe pa motiv përfitimi”. Hapësirat publike janë element kryesor i mirëqenies individuale dhe sociale, vende të jetës kolektive të një komuniteti, shprehje të larmisë së pasurisë së tyre të përbashkët natyrore dhe kulturore, si dhe një themel i identitetit të tyre.

Definicioni sipas grupit punues:

Hapësira Publike është ajo hapësirë/vend ku secili qytetar, pa dallime, gëzon të drejtën të ketë qasje lirshëm ta shfrytëzojë për aktivitete të ndryshme varësisht nga destinimi i saj (sheshe, parqe, ruge, shtigje, trotuare, objekte publike dhe hapësira e destinuar për to).

Të gjeturat & Rezultatet:

Përparësitë

Socializimi;

(Hapësira) pa pagesë dhe të qasshme;

Hapësirat publike rreth objekteve me rëndësi të veçantë rrisin cilësinë e hapësirës dhe rrisin turizmin.

Mangësitë

Mungesë gjelbrimi;

Mirëmbajtja (ndriçimi, mbeturinat, ulëset);

Siguria (qentë endacakë);

Qasja e personave me aftësi të kufizuar;

Mobilizimi urban;

Uzурpimi i hapësirave publike (banesat, parkingjet, joformale);

Infrastrukturë teknike joadekuate (e trashëguar).

Veprimet

Planifikim i mirëfilltë i hapësirave të gjelbëruara në tërë qytetin;

Plan adekuat i mirëmbajtjes dhe rritje e kapaciteteve komunale, si dhe vetëdijësim i qytetarëve për të mirën e përgjithshme;

Përmirësimi i qasjes përmes intervenimeve konkrete (identifikimi i të gjitha pengesave/barrierave fizike në qytet);

Pasurimi/furnizimi në mobiluar sipas standarteve bashkëkohore.

Aspektet teknike	4
Vlerësimi sipas treguesve (nga 20)	9
Vlerësimi gjeneral (nga 40)	13

Vlerësimi sipas treguesve

● Aspektet teknike ● Eftektiviteti funksional legjislativ



Diagrami 2. Rezultatet e qëndrueshmërisë për fushën tematike Hapësira Publike

Grupi 3: Parcelat dhe Bllloqet

Definicioni sipas Kornizës për Vlerësimin e Qëndrueshmërisë:

Parcela është njësi bazë e zhvillimit urban. E përcaktuar thjeshtë, parcelat janë pjesë toke të matura dhe regjistruara, plotësisht të qasura nga hapësira publike dhe të destinuar për ndërtimin e objekteve. Ajo definon madhësinë, funksionin e objektit dhe numrin e banorëve, si dhe burimet e nevojshme për ndërtim. Bllloqet janë grupe parcelash të ndara nga njëra-tjetra nga rrugët.

Bllloqet mund të ndryshojnë në mënyrë të konsiderueshme në formë dhe madhësi sipas konfigurimit të rrugëve, orientimit dhe topografisë, si dhe natyrës së nën-ndarjeve të parcelave dhe llojeve të ndërtesave që do të akomodohen.

Definicioni sipas grupit punues:

Parcela është sipërfaqe e caktuar e kufizuar e cila ka nr. të regjistruar në kadastrë. Parcela është njësi bazë e zhvillimit urban.

Bllloku është tërësi e disa parcelave të cilat kufizohen me rrugë. Bllloqet duhet të jenë kompakte dhe mjedis i qëndrueshëm.

Të gjeturat & Rezultatet:

Mangësitë

Ligjet me gjuhë të paqarta dhe dykuptimësi;

Regjistrimi i pronave është proces kompleks dhe mungojnë dokumentacionet kadastrale;

Ngritja e kapaciteteve profesionale dhe përmirësimi i kushteve të punës;

Mungojnë kriteret për përcaktimin e bllloqeve urbane (moszbatimi i rregullores së re).

Veprimet

Ligjet të jenë të kuptueshme për të gjithë qytetarët;


Ngritja e vetëdijësimit të qytetarëve për regjistrimin e pronave (trashëgimive);

Ngritja e numrit të punëtorëve dhe ngritja e kapaciteteve të tyre; Respektimi/Zbatimi i rregullores për kushtet dhe kriteret e bllloqeve urbane.

Aspektet teknike	9
Vlerësimi sipas treguesve (nga 20)	11
Vlerësimi gjeneral (nga 40)	20

Vlerësimi sipas treguesve

● Aspektet teknike ● Eftektiviteti funksional legjislativ



Diagrami 3. Rezultatet e qëndrueshmërisë për fushën tematike Parcelat dhe Bllloqet

Grupi 4: Të Drejtat Zhvillimore

Definicioni sipas Kornizës për Vlerësimin e Qëndrueshmërisë:

Të drejtat e zhvillimit i referohen gjerësisht 'të drejtave për të ndërmarrë zhvillim në tokë'.

Definicioni sipas grupit punues:

E drejta zhvillimore është vlerë e shtuar e të drejtës në pronë e cila përcaktohet nga institucioni publik.

Të gjeturat & Rezultatet:

Përparësitë

Përshejton zhvillimin ekonomik;
Barazi sociale dhe ekonomike.

Mangësitë

Degradimi i ambientit dhe trashëgimisë në emër të së drejtës për zhvillim;

Shkaktohen komplikime tek institucionet publike me kapacitete të ulëta;

Eksplotimi i resurseve në emër të së drejtës për zhvillim.

Veprimet


Zbatimi konsekuent i ligjit;

Krijimi i mekanizmave efikase për zbatimin e të drejtës zhvillimore.

Vlerësimi sipas treguesve (nga 20)	Aspektet teknike	6.67
	Efektiviteti funksional legjislativ	7.00
Vlerësimi gjeneral (nga 40)		13.67

Vlerësimi sipas treguesve

● Aspektet teknike ● Efektiviteti funksional legjislativ



Diagrami 4. Rezultatet e qëndrueshmërisë për fushën tematike Të Drejtat Zhvillimore

Grupi 5: Kodi i Ndërtimit

Definicioni sipas Kornizës për Vlerësimin e Qëndrueshmërisë:

Rregullat e duhura të planifikimit dhe rregulloret e ndërtesave janë një parakusht për furnizimin, dizajnimin, prodhimin dhe menaxhimin e banimit të përballueshëm, të sigurtë, rezilient (vet-ripërtrishëm) dhe efikas në energji. Rregulloret e ndërtimit dhe të përdorimit të tokës mund të zvogëlojnë rreziqet në qytete duke përfshirë (1) rrezikun e rasteve të mëdha, të menjëhershme dhe (2) rrezikun e rasteve më të përmbajtura, por ende vdekjeprurëse, si zjarri ose shembja e ndërtesave.

Definicioni sipas grupit punues:

Tërësi e rregullave teknike:

- Eficienca në energji;
- Materialet ndërtimore vendore;
- Siguria
- Banim i përballueshëm;
- Ndërlidhja me peisazhin (estetika).

Të gjeturat & Rezultatet:

Mangësitë

Mungesa e kodit të ndërtimit;

Vështirësitë në menaxhim të ndërtimit.

Veprimet


Hartimi i kodit të ndërtimit;

Aplikimi i ligjeve në fuqi (Ligji i ndërtimit, udhëzimi administrativ dhe rregullorja).

Vlerësimi sipas treguesve (nga 20)	Aspektet teknike	11
	Efektiviteti funksional legjislativ	9
Vlerësimi gjeneral (nga 40)		20

Vlerësimi sipas treguesve

● Aspektet teknike ● Efektiviteti funksional legjislativ



Diagrami 5. Rezultatet e qëndrueshmërisë për fushën tematike Kodi i Ndërtimit

Grupi 6: Financat e bazuara në Tokë

Definicioni sipas Kornizës për Vlerësimin e Qëndrueshmërisë:

Financat e bazuara në tokë janë një grup instrumentesh që mund të përshtaten në një sërë kontekstesh institucionale dhe kulturore. Synimi është të përmirësojë disponueshmërinë e burimeve për zhvillimin lokal.

Definicioni sipas grupit punues:

Mënyrat e ndryshme të menaxhimit të tokës që përdoren për gjenerimin e të hyrave për nivelin komunal.

Të gjeturat & Rezultatet:

Mangësitë

- Vlera joreale e kontratave;
- Mosinformimi publik (jo i mjaftueshëm);
- Çështja e legalizimit të pronave është e papërfunduar (dështuar);
- Mungesa e lehtësirave të përkthimit të tokave (ligji).



Veprimet

- Transaksionet duhet të kryhen përmes llogarive bankare;
- Takime më të shpeshta me qytetarët;
- Draftimi (hartimit) i ligjit për përkthim të tokave.

Vlerësimi sipas treguesve (nga 20)	Aspektet teknike	16.25
	Efektiviteti funksional legjislativ	11.00
Vlerësimi gjeneral (nga 40)		27.25

Vlerësimi sipas treguesve

● Aspektet teknike ● Efektiviteti funksional legjislativ



Diagrami 6. Rezultatet e qëndrueshmërisë për fushën tematike Financat e bazuara në Tokë

Rezultatet e përgjithshme nga

Grafikoni për Vlerësimin e Qëndrueshmërisë

Grafikoni i vlerësimit të qëndrueshmërisë paraqet rezultatet që kanë derivuar nga fushat tematike, duke vënë në pah njëkohësisht edhe mangësitë eventuale tek secila fushë tematike. Kur rezultatet e ndonjëres prej fushave tematike janë të ulëta, atëherë kërkohet më shumë vëmendje në adresimin dhe eliminimin e këtyre mangësive, në mënyrë që të përmirësohet situata brenda asaj fushe tematike.

Vlerësimi i përgjithshëm	
Zona e Planifikimit	Rezultati i përgjithshëm (nga 40)
Planifikimi urban dhe i tokës	30
Hapësira publike	13
Parcelat dhe blloqet	20
Të drejtat e zhvillimit	13.66
Kodi i ndërtimit	20
Financimi i bazuar në tokë	27.25




Tabela 3. Vlerësimi i përgjithshëm i qëndrueshmërisë për të gjitha fushat tematike dhe rezultatet (përfshirë grafikoni)

II. Vlerësimi i PZHK-së në bazë të kërkesave ligjore (të dhënat e nevojshme për HZK)

Të ndarë në 7 grupe, pjesëmarrësit vazhduan me mjetet e tjera të vlerësimit, në këtë rast plotësimin e tabelave/mjeteve të zhvilluara bazuar në anekset e UA nr. 11/2015 për Pjesët dhe Kërkesat Themelore për Hartimin, Zbatimin dhe Monitorimin e Planit Zhvillimor Komunal, si dhe Listës (shih Aneksin A) me të dhënat që kërkohen për HZK. Grupet e punës kanë analizuar të dhënat e përfshira në PZHK duke i krahasuar ato me të dhënat e nevojshme sipas udhëzimit përkatës administrativ. Secili grup përbëhej nga 4-5 anëtarë dhe ishte përgjegjës për 1, 2 apo 3 fusha tematike. Fushat tematike për këtë vlerësim janë grupuar varësisht nga volumi i të dhënave që duhen mbledhur dhe jo sipas ndërlidhjes direkte përmbajtësore. Vetëm sa për ilustrim, Infrastruktura Publike dhe Sociale si fushë tematike që kërkon volum të madh të të dhënanve që duhen mbledhur është ndarë vetëm një grupi, ndërsa Trashëgimia Kulturore dhe Natyrore është kombinuar me Mjedisin dhe Fatkeqësitë Natyrore, si fusha tematike me volum më të vogël të dhënave që kërkohen. Secili grup ka identifikuar të dhënat që mungojnë brenda fushës tematike përkatëse dhe i ka shënuar brenda tabelave përkatëse të punës. Pas kompletimit të tabelave, grupet kanë prezantuar gjetjet e tyre me anë të të cilave janë nxitur shumë diskutime. Disponueshmëria e të dhënave në PZHK u tregua në tre mënyra: e disponueshme (e gjelbër), pjesërisht e disponueshme (e verdhë) dhe jo e disponueshme (vjollcë). Vlerësimi, sipas përmbajtjes së tabelës, është realizuar në dy sesione: (1) vlerësimi i të dhënave të profilit të PZHK-së, dhe (2) vlerësimi i zhvillimit të planifikuar të PZHK-së. Fushat tematike dhe rezultatet e nxjerra janë të sqaruara dhe ilustruara me diagrame në paragrafet e mëposhtme, respektivisht Kapitullin 4 (Të gjeturat).



Grupi 1: Struktura e PZHK-së + Infrastruktura Ekonomike (Sipërfaqet)

Fusha e parë tematike ka të bëjë me strukturën dhe përmbajtjen e dokumentit të PZHK-së, dhe Infrastrukturën Ekonomike bazuar në sipërfaqe. Janë dy tabela që duhet të plotësohen, nga një për secilën temë. E para është tabela për strukturën e PZHK-së dhe ka të bëjë me pjesën tekstuale dhe hartografike të dokumentit. Qëllimi është të rishikohet përmbajtja e PZHK-së përfshirë hartat përkatëse nëse ato janë të përshtatshme dhe të bazuara mirë në legjislacionin në fuqi, gjithmonë duke mbajtur në mend hapin tjetër që është hartimi i HZK-së. Tabela e dytë bazohet në Infrastrukturën Ekonomike (sipërfaqet) e cila mbulon 6 sipërfaqe (ekonomike, tregtare, industriale, shërbyese, bujqësore dhe pyjore), si dhe kërkon të dhënat e mëposhtme: sipërfaqen e lokacionit (ha), paraqitjen në hartë dhe ndarjen sipas vendbanimeve.


Grupi 2: Vendbanimet + Infrastruktura e Banimit (Sipërfaqet/Objektet)

Fusha e dytë tematike fokusohet në dy tema prandaj duhen dy tabela të plotësuara. E para ka të bëjë me vendbanimet formale (urbane/rurale) dhe joformale, dhe kërkon të dhëna si sipërfaqja (ha), popullsia, densiteti dhe paraqitja në hartë. Tabela e dytë ka të bëjë me Infrastrukturën e Banimit, bazuar në tri kategori të sipërfaqeve: tipologjia, funksioni, përdorimi i përzier. Të dhënat që kërkohen janë: sipërfaqja e lokacionit (ha), numri i njërive të banimit, numri i ndërtesave, ndarja sipas vendbanimeve dhe paraqitja në hartë.

Grupi 3: Demografia + Infrastruktura Ekonomike (Ndërmarrjet/Të Punësuarit) + Buxheti

Seti tjetër i mjeteve të vlerësimit përfshin tri fusha tematike (rrjedhimisht tri tabela të plotësuara). Fusha e parë ka të bëjë me demografinë, e cila paraqet statistikën komonale bazuar në të dhënat e mëposhtme: popullsia, njësitet e ekonomive familjare, moshë, përkatësia etnike, shkalla e punësimit, arsimi, migracioni dhe rritja e popullsisë për 8 vitet e ardhshme. Fusha e dytë tematike trajton infrastrukturën ekonomike bazuar në dy tema. E para është ndërmarrjet ekonomike/publike dhe punonjësit, me tre nënkategoritë: ndërmarrje private ekonomike, ndërmarrje/institucione publike dhe ndërmarrje ekonomike me pronësi shoqërore (jo të privatizuara). Të dhënat e nevojshme për t'u identifikuar janë: numri i ndërmarrjeve/ institucioneve, numri i të punësuarve dhe ndarja sipas vendndodhjes/ vendbanimit. Fusha e tretë tematike trajton kapacitetet financiare në kuadër të shpenzimeve buxhetore dhe të ardhurave nga dita e miratimit të PZHK-së e deri më tani, përfshirë vitet e ardhshme.

#	Të dhënat	Struktura e PZHK-së (Pjesa tekstuale)	Struktura e PZHK-së (Pjesa hartografike)	Infrastruktura Ekonomike (Sipërfaqet)
1	Të disponueshme	84.03%	66.67%	24.59%
2	Të padisponueshme	15.13%	33.33%	75.41%
3	Pjesërisht të disponueshme	0.84%	0.00%	0.00%




Diagrami 7. Disponueshmëria e të dhënave për strukturën dhe infrastrukturën ekonomike (sipërfaqet) të PZHK-së.

#	Të dhënat	Vendbanimet	Infrastruktura e banimit (Sipërfaqet dhe Objektet)
1	Të disponueshme	24.28%	0.00%
2	Të padisponueshme	75.72%	100.00%
3	Pjesërisht të disponueshme	0.00%	0.00%



Diagrami 8. Disponueshmëria e të dhënave për vendbanimet dhe infrastrukturën e banimit (sipërfaqet dhe objektet).

#	Të dhënat	Demografia	Infrastruktura Ekonomike (Ndërmarrjet/Të Punësuarit)	Buxheti
1	Të disponueshme	0.00%	0.00%	
2	Të padisponueshme	99.84%	97.96%	100.00%
3	Pjesërisht të disponueshme	0.16%	2.04%	




Diagrami 9. Disponueshmëria e të dhënave për demografinë, infrastrukturën ekonomike (ndërmarrja) dhe buxheti

Grupi 4: Infrastruktura dhe Shërbimet Sociale/Publike


Ky grup mjetezsh fokusohet në sipërfaqet apo shërbimet e: shëndetësisë, arsimit, administrimit dhe mbrojtjes, mirëqenies sociale dhe komunitetit, religjionit, kulturës/rinisë dhe sportit/rekreacionit, dhe hapësirave publike. Tabelat përmbajnë një sërë të dhënash siç janë: sipërfaqja (ha), zona e ndërtesave kryesore/dytësore (m²), numri i personelit, numri i personave që shërbehen, madhësia e parcelës dhe zona e ndërtimit sipas standardeve, ndarja sipas vendbanimit, paraqitja në hartë, etj.

#	Të dhënat	Infrastruktura dhe Shërbimet Sociale/Publike
1	Të disponueshme	3.87%
2	Të padisponueshme	92.10%
3	Pjesërisht të disponueshme	4.03%




Diagrami 10. Disponueshmëria e të dhënave për Infrastrukturën dhe Shërbimet Publike

#	Të dhënat	Infrastruktura dhe Shërbimet Teknike
1	Të disponueshme	4.57%
2	Të padisponueshme	76.35%
3	Pjesërisht të disponueshme	19.07%




Diagrami 11. Disponueshmëria e të dhënave për Infrastrukturën dhe Shërbimet Teknike

#	Të dhënat	Infrastruktura e Transportit Publik
1	Të disponueshme	17.34%
2	Të padisponueshme	76.69%
3	Pjesërisht të disponueshme	5.96%



Diagrami 12. Disponueshmëria e të dhënave për Infrastrukturën e Transportit Publik

#	Të dhënat	Trashëgimia Kulturore dhe Natyrore	Ndotja e Mjedisit dhe Fatqësisë Natyrore
1	Të disponueshme	11.43%	16.55%
2	Të padisponueshme	72.97%	42.91%
3	Pjesërisht të disponueshme	15.60%	40.54%



Diagrami 13. Disponueshmëria e të dhënave për Trashëgiminë Kulturore/Natyrore dhe Mjedisin

Grupi 5: Infrastruktura dhe Shërbimet Teknike

Tabela për Shërbimet dhe Infrastrukturën Teknike ka për fokus aspektet teknike të komunës siç janë furnizimi me ujë, sistemet e ujërave të zeza, energjia elektrike dhe menaxhimi i mbeturinave. Të dhënat për këto shërbime sigurohen bazuar në vendbanime, numrin e përdoruesve, gjendjen fizike të sistemit, zonën e ndërtimit (m²), sipërfaqen e parcelës (ha), kapacitetet financiare dhe të infrastrukturës, etj.

Grupi 6: Infrastruktura e Transportit Publik

Tabelat e radhës për vlerësim identifikojnë të dhënat për kategoritë e infrastrukturës së transportit. Rrugët, hekurudhat, automjetet pa motor, infrastruktura e ndërtimit për transport ose çfarëdo lloj shërbimi tjetër, të gjitha i përkasin kësaj kategorie. Për të vlerësuar këtë kategori, kërkohen një sërë të dhënash si: vendbanimet e ndërlidhura, lloji, madhësia dhe gjerësia e rrugës, trotuaret dhe parkimi, shtigjet, zonat e ndërtesave, etj.

Grupi 7: Trashëgimia Kulturore/Natyrore + Mjedisin

Tabelat e fundit përfshijnë informacione për dy fusha tematike të cilat duhet të plotësohen. Fusha e parë ka të bëjë me trashëgiminë kulturore dhe natyrore, dhe nënkategoritë e tyre si: trashëgimia arkitektonike, arkeologjike dhe natyrore. Të dhënat e kërkuara në këtë tabelë janë vendbanimi, numri i ID-së dhe koordinatat, vendndodhja dhe madhësia e ndërtesës, statusi ligjor, paraqitja në hartë, etj.


Fusha e dytë ka të bëjë me mjedisin, ose më saktë ndotjen (katastrofat natyrore/njerëzore dhe rreziqet). Të dhënat e radhitura në tabelë vijnë kështu: vendbanimi/vendndodhja, hapësirat e ndotura/të kërcënuara, shkaku i ndotjes/rrezikut, paraqitja në hartë, etj.

KAPITULLI

04

Të gjeturat

Ky raport vlerësimi adreson dy komponentë të rëndësishëm në lidhje me PZHK-në e Vushtrisë siç janë kërkesat ligjore dhe vlerësimi i qëndrueshmërisë. Vlerësimi është bërë përmes mjeteve tabelare që shërbyen për identifikimin dhe mbledhjen e të dhënave të nevojshme. Të gjeturat kryesore janë nxjerrë duke pasur parasysh situatën aktuale të zhvillimit komunal, qëllimet e përcaktuara në PZHK dhe pajtueshmërinë me ligjin.






Ekzistojnë dallime të mëdha në mes rezultateve të temave/fushave të ndryshme të vlerësuara. Në këtë drejtim, rezultatet tregojnë se Planifikimi Urban dhe i Tokës qëndron relativisht mirë duke u vlerësuar me 30 pikë nga gjithësej 40 pikë, pasuar nga Financimi i Bazuar në Tokë që ka marrë gjithësej 27.25 pikë. Fushat tjera tematike si Kodi i Ndërtimit, Parcelat dhe Bllloqet janë vlerësuar me 20 pikë nga gjithësej 40. Me më pak pikë janë vlerësuar Hapësirat Publike dhe Të Drejtat për Zhvillim, duke nënkuptuar se kërkohet shumë më tepër angazhim institucional në trajtimin e çështjeve që ndërlidhen me këto fusha tematike.

Megjithatë, rezultatet tregojnë se ka dallime edhe brenda vet fushave tematike shiqar nga efektivitetit funksional apo aspektit teknik. Dallimet më të mëdha ekzistojnë brenda fushës tematike për Financimin e Bazuar në Tokë vlerësuar me 5 pikë dallim, resepektivisht 11 pikë për efektivitetin funksional dhe 16.25 për aspektin teknik. Sa i përket fushave tjera tematike, dallimi variron prej 1.66 deri 5 pikë. E vetmja fushë tematike më e balanuar sipas rezultateve, del të jetë Planifikimi Urban dhe i Tokës me pikë të barabarta si nga aspekti funksional poashtu edhe teknik.

Bazuar në rezultatet e përgjithëshme, nënkuptohet se mbetet shumë për tu bërë drejt menaxhimit më të mirë të zhvillimit të Komunës së Vushtrrisë. Për arritjen e objektivave për një zhvillim të qëndrueshëm, secila fushë tematike e trajtuar më lartë duhet të mbështetet jo vetëm me legjislacion përkatës, por edhe me kapacitete të mjaftueshme dhe adekuate profesionale brenda drejtorive komunale dhe institucioneve tjera përkatëse; mekanizma efikas të planifikimit/zbatimit/koordinimit, mbështetje të duhur financiare, dhe sistem të monitorimit/vlerësimit/raportimit. Përgjithësisht, rezultatet tregojnë se komuna ka qenë më efektive në përmbushjen e detyrave legjislative, ndërsa sa i përket aspektit teknik duhet bërë më shumë veçanarisht në aspektin e zbatimit të dokumenteve të planifikimit.

Vlerësimi sipas Treguesit		
Zona e Planifikimit	Treguesi	Nën-pikët (nga 20)
Planifikimi urban dhe i tokës	Efektiviteti funksional	15
	Aspektet teknike	15
Hapësira publike	Efektiviteti funksional	9
	Aspektet teknike	4
Parcelat dhe bllloqet	Efektiviteti funksional	11
	Aspektet teknike	9
Të drejtat e zhvillimit	Efektiviteti funksional	7
	Aspektet teknike	6.66
Kodet e ndërtimit	Efektiviteti funksional	9
	Aspektet teknike	11
Financimi i bazuar në tokë	Efektiviteti funksional	11
	Aspektet teknike	16.25



Diagrami 14. Rezultatet e krahasimit për të gjitha fushat tematike - Korniza e Vlerësimit të Qëndrueshmërisë



Përgjithësisht, të gjeturat nga vlerësimi tregojnë se ka mungesë të konsiderueshme të të dhënave për secilën fushë tematike, si në pjesën tekstuale poashtu dhe atë hartografike. Të gjitha rezultatet janë prezantuar në tabelën vijuese, e cila tregon se shumica e fushave tematike nuk kanë arritur të kalojnë vlerën prej 50% sa i përket disponueshmërisë me të dhëna përveç Strukturës së PZHK-së (pjesa tekstuale dhe hartografike).

PZHK përmban informacione të pjesërishme që mund të shfrytëzohen për planet territoriale dhe sektorale të zhvillimit (vizioni, qëllimet dhe objektivat; prioritetet strategjike dhe plani i veprimit; koncepti për zhvillim hapësinor dhe sektoral etc.). Sidoqoftë, në çdo skenar të paraparë për të ardhmen duhet patjetër të merret parasysh krijimi apo rifreskimi i bazës së të dhënave të planifikimit hapësinor për Komunën e Vushtrrisë, e cila do të ndihmonte procesin e planifikimit lokal. Për më shumë detaje, rezultatet sipas grupeve tematike janë këto:

Grupi 1: Struktura e dokumentit të PZHK-së dhe Infrastruktura Ekonomike/Sipërfaqet - (15.13% respektivisht 33.33% dhe 75.41% e të dhënave mungojnë)

Diagrami 7 (në kuadër të tabelës më lartë), ka të bëjë me Strukturën e Dokumentit të PZHK-së dhe fushën tematike të Infrastrukturës Ekonomike/sipërfaqet (Aneks B, tabela 1 dhe 2). Rezultatet nga ky diagram tregojnë se Struktura e PZHK-së qëndron mjaft mirë sa i përket përputhshmërisë me legjislacionin e planifikimit hapësinor, respektivisht 84.03% për pjesën tekstuale dhe 66.67% për pjesën hartografike. E njëjta nuk vlenë për fushën tematike të Infrastrukturës Ekonomike/Sipërfaqet ku 75.41% e të dhënave mungojnë. Poashtu, vlen të theksohet se ka disa të dhëna të cilat ekzistojnë në kuadër të drejtorive/institucioneve të ndryshme por ato nuk janë kërkuar nga drejtoritë/institucionet përkatëse dhe nuk janë prezantuar brenda pjesës tekstuale apo hartografike të PZHK-së, siç është rasti me zonën ekonomike. Sa i përket pjesës hartografike, ato nuk janë të sakta dhe ka mangësi të mëdha. Harta e shfrytëzimit të tokës në nivel të komunës është e paraqitur më shumë në nivelin konceptual se sa bazuar në situatën faktike. Poashtu, duhet të theksohet se baza e të dhënave ku janë punuar hartat nuk është dorëzuar fare tek autoritetet përkatëse të komunës nga kompania konsulente e cila hartoi PZHK-në (vlerësimi i të cilës po bëhet); kjo do të thotë se të gjitha hartat duhet të punohen nga fillimi (pas mbledhjes së të dhënave dhe krijimit të bazës së të dhënave). Autoritetet përgjegjëse komunale i bënë kërkesë zyrtare kësaj kompanie lidhur me GIS databazën, por nuk kanë marrë përgjigje deri më tani. Kjo vjen si rezultat i marrëdhënieve të dobëta dhe marrëveshjeve të papërcaktuara kontraktuale ndërmjet autoriteteve të planifikimit komunal dhe kompanisë konsulente gjatë procesit të zhvillimit të PZHK-së.

Grupi 2: Vendbanimet + Infrastruktura e Banimit - (mbi 75% respektivisht 100% e të dhënave mungojnë)

Diagrami 8 (Aneks B, Tabelat 3 dhe 4) tregon se nuk ka informacione të mjaftueshme (75% mungojnë) lidhur me Vendbanimet dhe Infrastrukturën e Banimit. Përveç emërtimeve (që shpesh janë shkruar gabimisht) të vendbanimeve, të dhënat tjera si sipërfaqja, numri i banorëve, densiteti për zonë kadastrale mungojnë për secilin vendbanim. Sipas pjesëmarrësve, drejtoritë komunale i posedojnë disa nga këto të dhëna por ato nuk janë kërkuar nga kompania konsulente përgjegjëse për hartimin e PZHK-së. Sa i përket vendbanimeve joformale, ato nuk janë identifikuar fare (si në pjesën tekstuale poashtu edhe atë grafike) edhe pse sipas pjesëmarrësve ende ka vendbanime joformale në kuadër të disa vendbanimeve të komunës.

Në lidhje me infrastrukturën e banimit, respektivisht ndarjen sipas karakterit, shfytëzueshmërisë, shfrytëzueshmërisë mikse, rezultatet tregojnë se 100% e të dhënave të nevojshme mungojnë si në pjesën tekstuale poashtu dhe në atë grafike. Më konkretisht nuk dihet sipërfaqja e lokacioneve, numri i njërive të banimit, numri i objekteve, raporti i shfrytëzueshmëirë në mes ta banimit individual/kolektiv, raporti i shfytëzueshmërisë mikse (sa janë hapësira banimi, komerciale, bujqësore, industriale apo shërbyese).

Grupi 3: Demografia + Infrastruktura Ekonomike (ndërmarrjet) + Buxheti – (më shumë se 97% e të dhënave mungojnë)

PZHK përmban shumë pak të dhëna për ekonominë dhe ndërmarrjet, ndërsa shumica e të dhënave rreth të punësuarve dhe demografisë nuk specifikohen. Diagrami 9 (Aneks B, Tabela 5, 6 dhe 7), tregon pothuasje 100% mungesë të të dhënave në të gjitha fushat tematike. Për demografinë, PZHK specifikon detaje të vogla siç janë numri i përgjithshëm i banorëve në zonën urbane/rurale apo projeksionet ndër vite, por sa i përket informatave specifike (sidomos për vendbanimet rurale) nuk ka asnjë të dhënë (99.84%) lidhur me popullsinë apo aspekte tjera demografike siç janë popullsia sipas etnisë dhe grupmoshave, punësimi, arsimit, numri i njërive familjare etj.

Fusha e Infrastrukturës Ekonomike poashtu shënon mungesë të madhe të të dhënave (97.96%), përkatësisht mungesë e numrit të të punësuarve, ndërmarrjeve apo vendndodhjes së tyre. E njëjta pason edhe për Buxhetin e planifikuar para apo pas hartimit të PZHK-së, për të cilin mungojnë të gjitha të dhënat adekuate (100%).

Grupi 4: Infrastruktura Publike dhe Sociale – (mbi 90% e të dhënave mungojnë)

Këto të dhëna përfshijnë sektore të rëndësishme sociale dhe publike, ndër to: shëndetësia, arsimi, kultura, objektet fetare, mirëqenia sociale dhe hapësirat publike. Megjithatë, Diagrami 10 (Aneks B, Tabela 8) tregon se pothuasje të gjitha të dhënat mungojnë. Sipërfaqet shëndetsore janë të përgjithësuara dhe të paraqitura në mënyrë jo të duhur dhe nuk ka të dhëna konkrete për shërbimet e kujdesit shëndetsor apo shpërndarjen e tyre; kjo infrastrukturë është pjesërisht e paraqitur në hartë, si dhe ka mungesë të planifikimit të infrastrukturës shëndetsore. Arsimi ofron një numër të vogël të dhënash për lokacionin dhe numrin e objekteve për nivelet arsimore relevante por ka mungesë të dhënash për numrin e studentëve. Shumë pak të dhëna janë identifikuar për shërbimet e mirëqenies sociale dhe kulturore/rekreative, respektivisht numri i shfrytëzuesve të ndihmës sociale dhe mosha e tyre, dhe disa nga objektet kulturore/sportive në komunë. Për të gjitha këto fusha janë dhënë rekomandime për përmirësime të përgjithshme por pa i detajizuar. Ndërsa, të dhëna për shërbimet fetare dhe administrative nuk figurojnë në PZHK.

Grupi 5: Infrastruktura dhe Shërbimet Teknike – (mbi 70% e të dhënave mungojnë)

Diagrami 11 (Aneks B, Tabela 9) tregon poashtu mungesë të dhënash për infrastrukturën teknike e cila përbën shërbimet kryesore komunale siç janë kanalizimi, ujësjellësi, energjia elektrike dhe menaxhimi i mbeturinave. Ato pak të dhëna që ekzistojnë janë pjesërisht të disponueshme, përkatësisht 19.07% e tyre. Vlen të ceket se të gjitha llojet e infrastrukturës teknike nuk janë grafikisht të ndara prandaj duhet të paraqiten në harta të veçanta e jo mbi njëra tjetrën.

Sipas të dhënave të identifikuar, fshatrat të cilat kanë nevojë për uje të pijes nuk janë përfshirë në PZHK ndërsa ndërtimi i impiantit të ujërave të zeza (pa lokacion të destinuar) është paraparë në dokument. Poashtu, matjet mbi sistemin e ujitjes në PZHK nuk përshtaten me situatën në terren e këto të dhëna janë shumë të rëndësishme për komunën e Vushtrrisë sepse shumica e popullsisë varet nga bujqësia, rrjedhimisht sistemi i ujitjes. Gjendja nuk është aq e mirë as në sektorin e menaxhimit të mbeturinave, shërbim i cili mbulohet në pjesën më të madhe të qytetit të Vushtrrisë por jo plotësisht në zonën rurale. Sipas pjesëmarrësve, komuna ka planifikuar 100% mbulueshmëri të fshatrave edhe pse kjo nuk është e paraparë në PZHK.

● Të disponueshme ● Të padisponueshme ● Pjesërisht të disponueshme



Diagrami 15: Krahasimi i disponueshmërisë së të dhënave të PZHK për të gjitha fushat tematike

Rezultatet e diagramit 12 (Aneks B, Tabela 10) tregojnë se pjesa më e madhe e të dhënave për infrastrukturën rrugore nuk janë të sakta si në pjesën tekstuale ashtu edhe në atë grafike. Të dhënat e identifikuar janë kryesisht rreth gjendjes dhe materialit të infrastrukturës rrugore (rreth 90% e rrugëve në Komunën e Vushtrisë janë të shtruara por në PZHK të dhënat paraqiten ndryshe), vendbanimeve nëpër të cilat kalojnë, paraqitjes në hartë dhe pronësisë së infrastrukturës rrugore.

Grupi 7: Trashëgimia Kulturore dhe Natyrore + Mjedisit – (72.97%, respektivisht 42.91% e të dhënave mungojnë)

Rezultatet e diagramit 13 (Aneks B, Tabela 11 dhe 12) tregojnë se të dhënat e trashëgimisë dhe mjedisit janë pjesërisht të disponueshme. Në PZHK janë listuar objektet e trashëgimisë kulturore por nuk ka të dhëna rreth sipërfaqes së lokacionit apo objektit dhe pothuajse asnjëra nuk është e paraqitur në hartë; PZHK parasheh hartimin e Planit të Konservimit dhe mirëmbajtjen e këtyre objekteve. Sa i përket mjedisit, pjesërisht janë cekur vendbanimet/lokacionet potenciale që përmbajnë hapësira të ndotura apo të rrezikuara nga fatkeqësitë natyrore, përfshirë shkaktarët e tyre; në PZHK tek Plani i Veprimit janë cekur disa nga masat e ndërmarra për mbrojtjen ndaj tyre.



Rezultatet nga të dyja vlerësimet (vlerësimi i qëndrueshmërisë dhe vlerësimi i ligjshmërisë) së bashku me diskutimet e pjesëmarësve tregojnë se ka dallime të konsiderueshme mbi mënyrën e perceptimit, respektivisht kuptimit të fushave tematike (planifikimi urban dhe i tokës, hapësirat publike, parcelat dhe blloqet, të drejtat zhvillimore, kodi i ndërtimit dhe financimi i bazuar në tokë), si dhe ndërlidhjen e tyre me produktet dhe proceset e planifikimit hapësinor.

Vetëmsapërilustrim, rezultatet nga vlerësimi i qëndrueshmërisë për fushën e parë tematike Planifikimi Urban dhe i Tokës tregojnë se kjo fushë qëndron relativisht mirë sa i përket legjislacionit përkatës. Në anën tjetër, rezultatet nga vlerësimi i dokumentit të PZHK-së tregojnë mungesë të madhe të të dhënave si dhe analizë hapësinore të kufizuar, që nënkupton se edhe pjesa e planifikuar tek koncepti zhvillimor nuk është plotësisht e mbështetur në situatën faktike në terren. Ky fakt tregon se korniza ligjore e planifikimit hapësinor, ndonëse relativisht mirë e kompletuar, nuk është zbatuar plotësisht gjatë hartimit të Planit Zhvillimor Komunal të Komunës së Vushtrisë.

Një rast tjetër që evidenton dallime të konsiderueshme është rasti i fushës tematike “Hapësirat Publike”. Rezultatet e vlerësimit të qëndrueshmërisë tregojnë se kjo fushë nuk është mirë e mbështetur me kornizë ligjore. Pavarësisht kornizës ligjore jo të mjaftueshme, sipas pjesëmarësve Komuna e Vushtrisë ka të paraparë një pozicion ‘Zyrtar për Hapësira Publike’ në kuadër të Drejtorisë për Shërbimeve Publike, por që nuk ka asnjë zyrtar të angazhuar në këtë pozicion. Megjithatë, në kuadër të Drejtorisë për Urbanizëm dhe Mbrojtje të Mjedisit aktualisht është një zyrtar që merret me ideimin e projekteve për hapësira publike, disa prej të cilave janë realizuar me buxhetin e ndarë nga komuna (për shembull sheshi ‘Hasan Prishtina’).

Edhe për fushat tjera tematike (Parcelat dhe blloqet, E drejta Zhvillimore, Kodi i Ndërtimit, Financimi i Bazuar në Tokë), dallimet janë evidente dhe kanë vënë në pah probleme edhe të trashëguara siç është rasti me regjistrin kadastral i cili nuk është i azhurnuar sipas ndryshimeve reale në terren. Ka raste kur në regjistrin kadastral figuron tokë bujqësore ndërsa në terren tashmë ekziston një ndërtesë shumëbanesore, ose rasti tjetër kur në regjistrë figuron si mal a realisht aty nuk ka më drunjë. Poashtu, rezultatet tregojnë se edhe pjesa grafike është e pakompletuar dhe nuk paraqet situatën faktike siç është rasti me infrastrukturën rrugore, publike, sociale, hartën e shfrytëzimit të tokës etj.

KAPITULLI

05

Përfundimet dhe rekomandimet

Bazuar në analizën e të gjeturave të të dyja vlerësimeve, këto janë konkluzionet e dalura:

Dokumenti i PZHK-së (struktura, të dhënat, përmbajtja)

Struktura: Shikuar nga perspektiva ligjore, Plani Zhvillimor i Komunës së Vushtrrisë i plotëson kushtet për të vazhduar me hartimin e Hartës Zonale të Komunës. Struktura e dokumentit aktual të PZHK-së përgjithësisht është në pajtim me kërkesat ligjore përkatëse për të dyja pjesët, grafike dhe tekstuale. Padyshim, të dyja pjesët (tekstuale dhe grafike) kanë mangësi dhe kërkojnë angazhim të konsiderueshëm për të plotësuar zbrazëtitë e lëna në kuadër të PZHK-së, e që janë të nevojshme për hartimin e Hartës Zonale të Komunës.

Sa i përket të dhënave dhe përmbajtjes (pjesa tekstuale dhe hartografike), dokumenti i PZHK-së nuk është në cilësinë e kënaqshme dhe këto janë disa nga mangësitë e identikuara:

Mungesa e të dhënave si dhe mungesa e argumentimit/ analizës së mirëfilltë e përcjellë gjithë dokumentin. Kjo vlen si për kapitullin e profilit, njëjtë edhe për kapitujt e pjesës së planifikuar (vizioni, qëllimet, objektivat, koncepti i zhvillimit hapësinor dhe plani i veprimit). Tek pjesa e profilit mungojnë në mes tjerash të dhënat demografike për secilin vendbanim, të dhënat për banim, sipërfaqet ekonomike, mungesa e të dhënave për vendbanimet joformale dhe tjera. Ndërsa tek pjesa e konceptit zhvillimor, edhe pse vizioni dhe objektivat qëndrojnë dhe janë aktuale, ato nuk janë ndërlidhur mirë me aktivitetet tek plani i veprimit, ku një pjesë e tyre janë shumë të përgjithësuara dhe nuk specifikojnë se për çka konkretisht bëhet fjalë (psh. Aktiviteti: Hulumtime të vazhdueshme dhe monitorime). Sigurisht kjo mungesë e të dhënave dhe cilësia jo e kënaqshme e dokumentit, vjen si rezultat i mungesës së bashkëpveprimit në mes të autoritetit përgjegjës komunal për planifikim hapësinor, drejtorive komunale, kompanisë së angazhuar.

Pjesa hartografike (përveç hartës së vendbanimeve joformale e cila mungon) përgjithësisht është në pajtim me kërkesat ligjore, por në disa raste nuk ka cilësinë e duhur si pasojë e mungesës së informatave të mjaftueshme. Si shembull, disa nga hartat më shumë kanë karakter konceptual dhe nuk përkojnë me situatën reale në terren (p.sh rasti i shfytëzimit të tokës në nivel të komunës). Në rastin tjetër, disa harta nxorrën në pah planifikimin jo adekuat siç është rasti me një numër të parqeve publike të parapara brenda zonës urbane në PZHK, e që në fakt janë të vendosura në pronë private. Sigurisht se ka edhe raste të tjera, por të gjitha do të adresohen dhe plotësohen gjatë procesit të hartimit HZK-së.

Mos-dorëzimi i bazës së të dhënave (GIS) nga kompania e cila ka hartuar PZHK-në, përbën sfidën kryesore në procesin e hartimit të Hartës Zonale të Komunës së Vushtrrisë. Në terma konkrete, kjo nënkupton se të gjitha hartat e PZHK-së mungojnë (në GIS) dhe për përpilimin e tyre duhet mbledhur të gjitha të dhënat që kërkohen me ligjet dhe UA përkatëse. Në anën tjetër, mbledhja, procesimi, analiza hapësinore dhe përpilimi i hartave kërkojnë kohën e duhur, kapacitetet adekuate menaxhuese, resurset njerëzore për mbledhjen/ përpunimin e të dhënave dhe përpilimin e hartave, si dhe mbështetjen financiare përkatëse (pajse, transport, stafi i angazhuar etj). Pra, ky proces kërkon koordinim dhe mbështetje të plotë jo vetëm nga Drejtoria për Urbanizëm dhe Mbrojtje të Mjedisit por nga të gjitha drejtoritë komunale që posedojnë të dhëna në sektoret e tyre përkatëse. Veç kësaj, duhet të krijohen mekanizma të posaçëm për kontrollin e vazhdueshëm të cilësisë së proceseve dhe produkteve të planifikimit hapësinor, përfshirë kontrollin/përditësimin e të dhënave të mbledhura. Në këtë drejtim, mbështetja nga MMPH është mëse e nevojshme, si në aspektin e këshillave profesionale poashtu në sigurimin e të dhënave nga institucionet/kompanitë publike, të cilat shumë shpesh hezitojnë të ndajnë të dhënat me palët tjera.

Qeverisja

Mungesa e një mekanizmi efikas për koordinim në kuadër të komunës, ka ndikuar që ndërveprimi të jetë i pamjaftueshëm dhe ad-hoc ndërmjet vetë drejtorive komunale; në mes të drejtorive komunale, kompanisë së angazhuar dhe palëve tjera relevante; në mes të komunës dhe ministrive relevante, si gjatë mbledhjes/përpunimit të të dhënave, poashtu edhe gjatë hartimit të PZHK-së (përfshirë debatet me publikun). Si rezultat i gjithë kësaj, nuk ka pasur një mekanizëm adekuat për të siguruar cilësinë e gjithë procesit dhe produktit të planifikimit, në këtë rast dokumentit të PZHK-së. Në këtë drejtim, trupa përkatës koordinues dhe punues (me Drejtorinë e Urbanizmit në rolin drejtues) duhet të krijohen për të siguruar transparencë dhe cilësi të duhur të të gjithë procesit/produktit, por edhe kërkim të llogaridhënies nga palët e angazhuara për hartimin e dokumentit të planifikimit.

Përfshirja e fragmentuar e stafit komunal gjatë procesit të hartimit të PZHK-së është e evidente. E rëndësishme është se gjatë kësaj punëtorie të gjitha drejtoritë u njoftuan se për të menaxhuar procesin e planifikimit, organizimit dhe hartimit të dokumenteve të planifikimit hapësinor (si PZHK, HZK etj.) duhet mobilizim shumë më i madh i stafit komunal gjatë gjithë procesit. Stafi komunal duhet të jetë shumë i përgatitur dhe proaktiv, sidomos në rastin kur komuna mbështetet nga palë tjera (kompani konsulente ose organizata tjera) ku marrëdhëniet kontraktuale duhet të jenë shumë mirë të definuara. Detyra e tyre, përveç ofrimit të të dhënave, është edhe sigurimi i transparencës, gjithëpërfshirjes dhe cilësisë së procesit dhe produktit të planifikimit hapësinor. Kjo nënkupton se komuna duhet të jetë e hapur për të gjitha palët, duke nxitur poashtu pjesëmarrjen e shoqërisë civile, respektivisht OJQ-ve, në mënyrë që të krijohet një masë solide kritike që do të mund të ishte shumë më aktive dhe kontribuese në proceset e planifikimit hapësinor.

Nevoja për më shumë mbështetje nga niveli qendror për stafin komunal është mëse e nevojshme, sidomos kur fillon hartimi i produkteve të reja të planifikimit që dalin si rrjedhojë e reformës ligjore të planifikimit, siç është rasti me Hartën Zonale të Komunës (përfshirë databazën). Në këtë drejtim, komuna duhet të jetë shumë më proaktive në kërkim të mbështetjes teknike nga ministria përkatëse, duke nxitur koordinim më të mirë vertikal dhe horizontal mes dy niveleve të qeverisjes dhe palëve tjera (përfshirë qytetarët, OJQ-të, bizneset, kompanitë publike, kompanitë konsulente) gjatë hartimit dhe zbatimit të dokumenteve të planifikimit. Në anën tjetër, është e rëndësishme që reforma ligjore dhe institucionale që ndërlidhet me fushën e planifikimit hapësinor të jetë e bazuar në analizë të mirëfilltë të gjendjes reale në terren, kapaciteteve ekzistuese njerëzore, financiare dhe kohore brenda secilës komunë veç e veç. Vetëm në këtë mënyrë mund të identifikohen lehtë zbrazëtitë e nevojshme për mbështetje teknike e financiare, siç është rasti me kapacitetet njerëzore që duhen për mbledhjen/digjitalizimin e të dhënave të nevojshme për hartimin e Hartës Zonale të Komunës, respektivisht planifikimit, organizimit, dhe menaxhimit të procesit të hartimit të këtij dokumenti.

Bazuar në përfundimet e lartpërmendura, rekomandohet të vazhdohet me mbledhjen, përpunimin dhe ndërtimin e bazës së të dhënave për planifikim hapësinor duke u bazuar në kërkesat aktuale legjislative të zhvillimit lokal, si dhe të hartohet HZK-ja bazuar në PZHK-në ekzistuese, planet sektoriale të azhurnuara dhe bazës së të dhënave.

Në këtë aspekt:

- Komuna tashmë ka marrë vendimin në Kuvendin Komunal që me mbështetjen e UN-Habitat të hartojë HZK-në së brendshmi (përfshirë bazën e të dhënave hapësinore).

- Programi dhe Komuna (nën drejtimin e Drejtorisë së Urbanizmit) tashmë kanë krijuar grupet e nevojshme të koordinimit, punuese dhe drejtuese (Ekipi Komunal i Planifikimit/EKP dhe Komiteti Drejtues/KD) për krijimin e bazës së të dhënave, përkatësisht HZK, si dhe për të siguruar koordinim më të mirë me të gjitha palët përkatëse (qendrore/lokale/rajonale, kompaninë/organizatën konsulente, shoqërinë civile dhe qytetarët) dhe cilësinë e procesit të planifikimit dhe produkteve përkatëse.

Në lidhje me hartimin e HZK, Programi dhe Komuna janë dakorduar që:

- Rëndësi e veçantë duhet dhënë plotësisht të planeve sektoriale të PZHK-së gjatë procesit të hartimit të HZK-së (për të dyja pjesët, narrative dhe grafike) e sidomos hartës së përdorimit të tokës, demografisë, infrastrukturës etj. të cilat janë thelbësore për zhvillimin e zonave (neni 44 i UA mbi HZK-në). Në këtë drejtim, zhvillimet e tanishme në terren duhet të pasqyrohen ashtu siç janë përmes mjeteve për mbledhjen e të dhënave, para fillimit të hartimit të HZK.

Në lidhje me bazën e të dhënave hapësinore, Komuna e Vushtrrisë mbështetur nga Programi për Zhvillim Gjithëpërfshirës i UN-Habitat, ka identifikuar të dhënat që mungojnë dhe burimet prej të cilave ato duhet të mblidhen. Dy metodat e aprovuara për mbledhjen e të dhënave janë:

- Mbledhja e të dhënave në terren me ndihmën e asistentëve për të gjitha objektet (banim, komerciale, industriale, agrikuturore etj.) që janë prezente në territorin komunal, përfshirë të dhënat si tiplogjia e objektit, etazhiteti, përdorimi i parcelës etj. Të gjitha vendbanimet urbane dhe rurale, në total 65, do të analizohen detajisht.

- Mbledhja e të dhënave të infrastrukturës (ekonomike, sociale, mjedisore, publike/sociale, teknike, të transportit, etj.) nga institucionet/organizatat lokale/rajonale/qendrore me ndihmën e asistentëve për mbledhjen e të dhënave dhe konsulentëve të GIS (përpunimi i të dhënave dhe përpilimi i hartave të reja), proces ky i mbështetur nga Programi dhe Komuna.

Programi do të:

- ndërtojë strukturën e GIS e cila do të shfrytëzohet nga Komuna për akomodim të bazës së të dhënave të planifikimit hapësinor. Struktura e GIS do të përdoret gjithashtu për kryerjen e analizave hapësinore dhe zhvillimin e planeve hapësinore lokale, përkatësisht pjesën grafike

Në funksion të kësaj, Bordi i Drejtorëve (BD) ka përgatitur dhe miratuar planin e integruar të punës (ndërtimi i bazës së të dhënave hapësinore, hartimi i HZK) dhe metodologjinë e mbledhjes së të dhënave.



ANEKSI



ANEKS A

Lista me databazën e nevojshme për hartimin e Hartës Zonale të Komunës

Të dhënat e përgjithshme për nevoja të hartës zonale:

- Kufiri i Komunës, zonave kadastrale, njësive administrative, zonës (zonave) urbane dhe zonave të veçanta;
- Regjistrin më të fundit të hartave kadastrale (me parcela) për secilën zonë kadastrale të Komunës dhe me ndarje për pronat private, publike/komunale, publike/ qendrore dhe publike/ ish-sociale;
- Ortofotot më të reja për territorin e Komunës;
- Hartat topografike më të reja për territorin e Komunës;
- Të dhënat hapësinore për sipërfaqet e resurseve ujore sipërfaqësore dhe nëntokësore duke përfshirë edhe zonat mbrojtëse të tyre;
- Të dhënat hapësinore për koridoret kryesore rrugore (nacionale dhe regionale)

Të dhënat që nevojiten nga planet/databaza e nivelit qendror për nevoja të hartës zonale (sipas UA për HZK):

- Të dhënat hapësinore (hartat, etj.) e Planit Hapësinor të Kosovës me planifikimet për regjionin dhe komunën;
- Të dhënat hapësinore (hartat, etj.) e Hartës Zonale të Komunës me zonimin për komunën;
- Të dhënat hapësinore (hartat, etj.) e Planeve Hapësinore të nivelit qendror (zonat e veçanta, zonat e veçanta të mbrojtura, etj) me planifikimet për regjionin dhe komunën;
- Ndërtesat dhe parcelat kadastrale që i përkasin ndërtesave me rëndësi për Kosovën (duke përfshirë edhe pronat ushtarke që përdoren tani dhe të mbetura nga ish-Jugosllavia);

Të dhënat hapësinore që nevojiten nga PZHK – ja (të detalizuara sipas UA për PZHK) për nevoja të hartës zonale (sipas UA për HZK):

- Harta e të dhënave bazë;
- Harta e zhvillimit hapësinor (vendbanimet ekzistuese/ të planifikuara dhe hapësirat për ndërtim me masat mbrojtëse për zhvillim);
- Harta e shfrytëzimit të tokës (banimore, bujqësore, komerciale, teknologjike, industriale dhe shfrytëzim të përzier);
- Planet zhvillimore sektorale me hapësira, ndërtime dhe infrastrukturë të planifikuar (mbitokësore dhe nëntokësore) (dhe të dhëna textuale/ numerike):
 - Të dhënat hapësinore (hartat, etj.) të planit të zhvillimit ekonomik;
 - Të dhënat hapësinore (hartat, etj.) të infrastrukturës së transportit;
 - Të dhënat hapësinore (hartat, etj.) të transportit urban dhe rural;
 - Të dhënat hapësinore (hartat, etj.) të energjisë elektrike dhe termike;
 - Të dhënat hapësinore (hartat, etj.) të ujësjellësit dhe kanalizimit;
 - Të dhënat hapësinore (hartat, etj.) të ujitjes dhe drenazimit;
 - Të dhënat hapësinore (hartat, etj.) të menaxhimit të mbeturinave dhe reciklim;
 - Të dhënat hapësinore (hartat, etj.) të telekomunikacionit dhe instalimeve të ngjashme;
 - Të dhënat hapësinore (hartat, etj.) të hapësirave publike dhe sociale;
 - Të dhënat hapësinore (hartat, etj.) të hapësirave sportive;
 - Të dhënat hapësinore (hartat, etj.) të hapësirave të hapura publike dhe të gjelbra;
 - Të dhënat hapësinore (hartat, etj.) të menaxhimit të varrezave;
 - Të dhënat hapësinore (hartat, etj.) të mbrojtjes së trashëgimisë natyrore dhe kulturore; dhe
 - Të dhënat hapësinore (hartat, etj.) të mbrojtjes nga rreziqet natyrore;
- Plani i veprimtimit (nëse është i paraqitur grafikisht)

Të dhënat që nevojiten nga planet operative/ monitoruese të nivelit komunal për nevoja të hartës zonale (sipas UA për HZK):

- Të dhënat hapësinore (hartat, etj) nga planet ekzistuese rregulluese të hollësishme/ urbane;
- Të dhënat hapësinore (hartat, etj) nga raportet monitoruese të zbatimit të planeve komunale (PZHK, HZK dhe PRRH);

Të dhënat që nevojiten nga planet sektoriale të Komunës për nevoja të hartës zonale (sipas UA për HZK):

- Të dhënat hapësinore (hartat, etj) nga: Planet Afatgjata dhe Vjetore për Menaxhimin e Pyjeve, Plani për Menaxhimin e Mbeturinave, Plani 3-vjeçar i Banimit, Plani Lokal i Veprimtimit në Mjedis, etj.;

Të dhënat e gjendjes ekzistuese (duke përfshirë edhe shfrytëzimin aktual të tokës sipas UA për Databazë të Planifikimit Hapësinor) me bazë në parcelë për nevoja të hartës zonale:

- Të dhënat hapësinore për vendbanimet ekzistuese formale (sipas numrit të banorëve) dhe jo formale (sipas karakteristikave) me kufinj të bazuar në parcela; me ndarje urbane/ rurale;
- Të dhënat hapësinore për banimin me ndarje të banimit të individual dhe kolektiv; me ndarje të veçantë, dysh/në varg; dhe me ndarje sipas përzierjes (me aktivitete bujqësore, pyjore, komerciale, industriale, shërbyese, etj; duke përfshirë edhe objektet;
- **Infrastruktura ekonomike:**
 - Të dhënat hapësinore për tokën bujqësore të punueshme (ara, kopshte, vreshta, pemishte dhe livadhe) dhe të pa punueshme (kullosa, hurdhë peshku dhe moçale); sipas përshtatshmërisë, zonave agroekologjike dhe sipas shfrytëzueshmërisë (e punuar, jo e punuar/ djerrë dhe me aktivitete përcjellëse (komercijale, etj)); duke përfshirë edhe ndërtesat mbështetëse dhe infrastrukturën e ujitjes;
 - Të dhënat hapësinore për tokë pyjore sipas shfrytëzimit (tokë pyjore për shfrytëzim ekonomik, tokë pyjore e mbrojtur dhe tjera) dhe sipas llojit (pyje të larta, pyje të ulëta dhe pyje me bimësi);
 - Të dhënat hapësinore për sipërfaqet e veprimtarisë komerciale (tregëti me shumicë/ pakicë dhe riparim i automjeteve/ mallrave shtëpiake);
 - Të dhënat hapësinore për sipërfaqet e veprimtarisë industriale (minierë dhe gurore, përpunimi i lëndës së parë, prodhimtari e rëndë, prodhimtari e lehtë, etj.);
 - Të dhënat hapësinore për sipërfaqet e veprimtarisë shërbyese (hotelieri dhe shërbim, patundshmëri, financiare dhe të sigurimeve, profesionale dhe shkencore, informacionit dhe komunikimit, administrative përcjellëse, etj.);
- **Trashëgimia natyrore dhe kulturore:**
 - Të dhënat hapësinore për sipërfaqet me vlera të mbrojtura të natyrës;
 - Të dhënat hapësinore për sipërfaqet/ndërtesat e mbrotjura të trashëgimisë kulturore;
- **Infrastruktura sociale:**
 - Të dhënat hapësinore për infrastrukturën administrative, sociale dhe mbrojtëse;
 - Të dhënat hapësinore për infrastrukturën arsimore;
 - Të dhënat hapësinore për infrastrukturën shëndetësore;
 - Të dhënat hapësinore për infrastrukturën e institucioneve kulturore/ argëtuese;
 - Të dhënat hapësinore për infrastrukturën e institucioneve sportive dhe hapësirave rekreative;
 - Të dhënat hapësinore për hapësirat e gjelbra;
 - Të dhënat hapësinore për infrastrukturën fetare dhe të komunitetit;
- **Infrastruktura e transportit:**
 - Të dhënat hapësinore për infrastrukturën e transportit rrugor lokal (lokale, të vendbanimeve, urbane, lidhëse, etj) dhe parkingjet/ garazhat publike; për korsitë dhe shtigjet e biçikletave; për këmbësorë.
 - Të dhënat hapësinore për infrastrukturën e transportit hekurudhor;
 - Të dhënat hapësinore për infrastrukturën e transportit ajror;
- **Infrastruktura teknike:**
 - Të dhënat hapësinore për infrastrukturën e ujësjellësit dhe kanalizimit (infrastruktura dhe mbulueshmëria);
 - Të dhënat hapësinore për infrastrukturën energjetike (infrastruktura dhe mbulueshmëria); të nxemjes (termike) dhe të gazit;
 - Të dhënat hapësinore për infrastrukturën e menaxhimit të mbeturinave (mbulueshmëria);
- **Infrastruktura e mjedisit:**
 - Të dhënat hapësinore për sipërfaqet e degraduara/ ndotura (nga industrinë);
 - Të dhënat hapësinore për zonat me rrezikshmëri (nga vërshimet, erozionet);

1: Planifikimi urban dhe i tokës

Treguesi	Nën-treguesi		Renditja					Rezultati/p ikët	Pesha	Totali i pikëve
			0	1	2	3	4			
Efektiviteti funksional legjislativ	1a.1	Konsistenca e objektivave të politikës	Korniza rregullative në këtë fushë nuk ka politika dhe nuk ka objektiva të qarta.	Ekzistojnë politika jo-konsistente si dhe ligjet kanë objektiva të ndryshme të politikave.	Ekzistojnë politika konsistente në këtë fushë por rregulloret kanë objektiva të ndryshme.	Masat rregullatore në këtë fushë kanë objektiva konsistente.	Masat rregullatore në këtë fushë kanë objektiva konsistente të bazuara në politika të qarta.	4	1	4
	1a.2	Transparenca dhe efikasiteti i mekanizmave dhe proceseve	Procesi i komplikuar dhe burokratik, ku si rezultat vendimi lihet plotësisht në diskrecion të zyrtarëve publik.	Proces kompleks dhe jo-transparent. Ekzistojnë disa rregulla për orientimin e rezultatit të vendimit, por ato lehtë mund të manipulohen.	Proceset janë të përcaktuara në mënyrë të qartë me një shkallë të mjaftueshme të diskrecionit, por nuk funksion mekanizmi i kontrollit dhe balancës (p.sh. miratimi hierarkik nga institucionet e ndryshme, pjesëmarrja publike, konsultimi, apelimi tek gjykata etj.)	Proceset janë të përcaktuara në mënyrë të qartë me një shkallë të mjaftueshme të diskrecionit. Funksionojnë mekanizmat e kontrollit dhe balancës (p.sh. miratimi hierarkik nga institucionet e ndryshme, pjesëmarrja publike, konsultimi, apelimi tek gjykata etj.)	Proceset janë përcaktuar në mënyrë të qartë dhe plotësisht transparente në mënyrë që rezultati i vendimit të mos përfshij asnjë diskrecion.	3	1	3
	1a.3	Organizimi i përgjegjësive dhe roleve institucionale	Disa institucione kanë përgjegjësi për zbatimin e rregulloreve, dhe nuk ka mekanizëm bashkërendues.	Disa institucione kanë përgjegjësi për zbatimin e rregulloreve. Ekzistojnë mekanizmat e bashkërendimit, por nuk funksionojnë.	Disa institucione kanë përgjegjësi për zbatimin e rregulloreve. Ekzistojnë mekanizmat e koordinimit, por funksionojnë me raste.	Rolet dhe përgjegjësitë institucionale në këtë sektor janë të koncentruara në një institucion që jo gjithmonë punon në mënyrë efikase.	Rolet dhe përgjegjësitë institucionale në këtë sektor janë të koncentruara në një institucion efikas ose tek disa institucione të mirë-koordinuara.	3	1	3
	1a.4	Qartësia në standardin e hartimit	Gjuhë jashtëzakonisht e paqartë dhe me dykuptimësi, ku interpretimi lihet plotësisht në diskrecion të zyrtarëve publik.	Gjuhë e paqartë dhe me dykuptimësi ku ekzistojnë disa rregulla ose vendime gjyqësore për orientimin e rezultatit të vendimit, por ato lehtë mund të manipulohen.	Gjuhë e paqartë dhe me dykuptimësi ku ekzistojnë disa rregulla ose vendime gjyqësore që ndihmojnë interpretimin.	Tekstet legjislative janë të shkruara në gjuhë të qartë dhe precize, të kuptueshme vetëm nga profesionistët.	Tekstet legjislative janë të shkruara në gjuhë të qartë dhe precize, të kuptueshme nga profesionistët dhe qytetarët e rëndomtë.	3	1	3
	1a.5	Kapaciteti për zbatim	Burimet njerëzore dhe financiare janë të pamjaftueshme për të zbatuar kornizën legjislative.	Burimet njerëzore dhe financiare janë të pamjaftueshme për të zbatuar kornizën legjislative, por mund të përmirësohen brenda disa vitesh (+5 vite) përmes ngritjes së kapaciteteve.	Burimet njerëzore dhe financiare janë të pamjaftueshme për të zbatuar kornizën legjislative, por realisht mund të përmirësohen brenda disa vitesh (2-3 vite) përmes ngritjes së kapaciteteve.	Burimet njerëzore dhe financiare pothuaj se të mjaftueshme.	Burimet njerëzore dhe financiare janë të mjaftueshme për të zbatuar me sukses kornizën legjislative në këtë fushë.	2	1	2
Menaxhimi i tokës: Aspektet teknike	1b.1	Regjistri ligjor i tokës	Nuk ka sistem informacioni për tokën në qytet.	Sistemi i informacionit është i pranishëm në qytet por nuk ka mbulueshmëri dhe/ose nuk është i përditësuar.	Sistemi i informacionit është i pranishëm në qytet por mbulon vetëm pjesërisht qytetin (më pak se 80%) dhe/ose nuk është i përditësuar në mënyrë të duhur.	Sistemi i informacionit të tokës mbulon më shumë se 80% të komunës dhe është i përditësuar në mënyrë të duhur.	100% e tokës në komunë regjistrohet në një kadastro dhe informatat e saj janë të përditësuara dhe janë në dispozicion të publikut.	3	1	3
	1b.2	Sisteme fleksibile dhe me përgjegjësi shoqërore të banimit	Njihen vetëm të drejtat formale statutores.	Legjislacioni njih vetëm të drejtat formale statutores, por ekzistojnë mekanizma për të njohur të drejtat joformale të tokës (p.sh. parashkrimin fitues, titujt e uzurpimit, format jo-dokumentare të dëshmimeve, etj.)	Legjislacioni njih të drejtat statutores dhe zakonore. Ekzistojnë mekanizmat për të njohur të drejtat joformale të tokës (p.sh. parashkrimin fitues, titujt e uzurpimit, format jo-dokumentare të dëshmimeve, etj.). Procesi i regjistrimit ose pagesa e tij është pengese e theksuar.	Legjislacioni është i përgjegjshëm ndaj çështjeve gjinore dhe njih të drejtat statutores dhe zakonore. Ekzistojnë mekanizmat për të njohur të drejtat joformale të tokës (p.sh. parashkrimin fitues, titujt e uzurpimit, format jo-dokumentare të dëshmimeve, etj.). Ekziston një proces i thjeshtuar i regjistrimit për herë të parë.	Legjislacioni është i përgjegjshëm ndaj çështjeve gjinore dhe njih të drejtat statutores, zakonore dhe joformale. Ekziston një proces i thjeshtuar i regjistrimit për herë të parë. Ekzistojnë mekanizma për të njohur uzurpimin dhe për të dhënë siguri jo-pronësore të banimit	1	1	1
	1b.3	Hierarki e koordinuar e planifikimit	Nuk ka asnjë mekanizëm evident për të ndërlidhur planet me njëri-tjetrin.	Ekzistojnë mekanizmat ligjorë për të lidhur planet me njëri-tjetrin, por me nivele të larta të diskrecionit në të gjitha nivelet.	Ekzistojnë mekanizmat ligjorë për të lidhur planet me njëri-tjetrin, por nuk sigurojnë pajtueshmëri me plane më të mëdha dhe nuk udhëzojnë planet më të vogla.	Hierarkia e planifikimit urban është e qartë, por ka mbivendosje institucionale dhe administrative.	Hierarkia e planifikimit urban është e qartë dhe mekanizmat ligjorë sigurojnë që planet e nivelit lokal përputhen me planet e niveleve më të larta. Planet janë të përshtatshme për nevojat lokale.	4	1	4
	1b.4	Mundësia për ndryshime të shfrytëzimit të tokës	Planet urbanistike ose nuk ekzistojnë ose nuk mundësojnë ndryshime në përdorimin e tokës.	Sipas planeve urbane, ndryshimi i përdorimit të tokës është i mundur, por procesi i aplikimit zgjat të paktën 12 muaj.	Sipas planeve urbane, ndryshimi i përdorimit të tokës është i mundur, por procesi i aplikimit zgjat të paktën 9 muaj.	Sipas planeve urbane, ndryshimi i përdorimit të tokës është i mundur, me transparencë dhe pa diskrecion, por procesi i aplikimit zgjat të paktën 6 muaj.	Planet përcaktojnë se cilat ndryshime të përdorimit të tokës janë të mundshme me transparencë dhe pa diskrecion. Procesi i aplikimit zgjat më pak se 2 muaj. Planet e përdorimit të tokës lejojnë mbivendosje në rrethet ekzistuese me përdorim të vetëm.	4	1	4
	1b.5	Planifikim i politikave të shkallës dhe banimit të përballueshme	Nuk kërkohet që planet urbane të marrin në konsideratë projeksionet demografike dhe migratore dhe t'i lidhin me furnizimin e banimit të përballueshëm.	Planet urbane marrin parasysh projeksionet demografike por nuk planifikojnë në shkallë dhe marrin parasysh zbatimin e politikave të banimit të përballueshëm.	Planet urbane marrin parasysh projeksionet demografike dhe migratore, por nuk planifikojnë në shkallë dhe marrin parasysh zbatimin e politikave të banimit të përballueshëm.	Planet urbane duhet të marrin parasysh projeksionet demografike dhe migratore dhe t'i lidhin ato me furnizimin e banimit të përballueshëm përveç tokës me gjitha shërbimet komunale, por jo në nivel të duhur.	Planet urbane duhet të marrin parasysh projeksionet demografike dhe migratore dhe t'i lidhin ato me furnizimin e banimit të përballueshëm dhe tokës me gjitha shërbimet komunale përmes një sërë instrumentesh (furnizim publiko/privat, subvencione për banim/qira etj.)	3	1	3

ANEKS B

Korniza për Vlerësimin e Qëndrueshmërisë (mjetet e vlerësimit)

Efektiviteti funksional legjislativ:	15
Aspektet teknike:	15
Rezultati i përgjithshëm:	30

2: Hapësira Publike

Treguesi	Nën-treguesi		Renditja				Rezultati/ pikët	Pesha	Totali i pikëve	
			0	1	2	3				4
Efektiviteti funksional legjislativ	2a.1	Konsistenca e objektivave të politikës	Korniza rregullative në këtë fushë nuk ka politika dhe nuk ka objektiva të qarta.	Ekzistojnë politika jo-konsistente si dhe ligjet kanë objektiva të ndryshme të politikave.	Ekzistojnë politika konsistente në këtë fushë por rregulloret kanë objektiva të ndryshme.	Masat rregullatore në këtë fushë kanë objektiva konsistente.	Masat rregullatore në këtë fushë kanë objektiva konsistente të bazuara në politika të qarta.	2	1	2
	2a.2	Transparenca dhe efikasiteti i mekanizmave dhe proceseve	Procesi i komplikuar dhe burokratik, ku si rezultat vendimi lihet plotësisht në diskrecion të zyrtarëve publik.	Proces kompleks dhe jo-transparent. Ekzistojnë disa rregulla për orientimin e rezultatit të vendimit, por ato lehtë mund të manipulohen.	Proceset janë të përcaktuara në mënyrë të qartë me një shkallë të mjaftueshme të diskrecionit, por nuk funksion mekanizmi i kontrollit dhe balancës (p.sh. miratimi hierarkik nga institucionet e ndryshme, pjesëmarrja publike, konsultimi, apelimi tek gjykata etj.)	Proceset janë të përcaktuara në mënyrë të qartë me një shkallë të mjaftueshme të diskrecionit. Funksionojnë mekanizmat e kontrollit dhe balancës (p.sh. miratimi hierarkik nga institucionet e ndryshme, pjesëmarrja publike, konsultimi, apelimi tek gjykata etj.)	Proceset janë përcaktuar në mënyrë të qartë dhe plotësisht transparente në mënyrë që rezultati i vendimit të mos përfshij asnjë diskrecion.	2	1	2
	2a.3	Organizimi i përgjegjësive dhe roleve institucionale	Disa institucione kanë përgjegjësi për zbatimin e rregulloreve, dhe nuk ka mekanizëm bashkërendues.	Disa institucione kanë përgjegjësi për zbatimin e rregulloreve. Ekzistojnë mekanizmat e bashkërendimit, por nuk funksionojnë.	Disa institucione kanë përgjegjësi për zbatimin e rregulloreve. Ekzistojnë mekanizmat e koordinimit, por funksionojnë me raste.	Rolet dhe përgjegjësitë institucionale në këtë sektor janë të koncentruara në një institucion që jo gjithmonë punon në mënyrë efikase.	Rolet dhe përgjegjësitë institucionale në këtë sektor janë të koncentruara në një institucion efikas ose tek disa institucione të mirë-koordinuara.	2	1	2
	2a.4	Qartësia në standardin e hartimit	Gjuhë jashtëzakonisht e paqartë dhe me dykuptimësi, ku interpretimi lihet plotësisht në diskrecion të zyrtarëve publik.	Gjuhë e paqartë dhe me dykuptimësi ku ekzistojnë disa rregulla ose vendime gjyqësore për orientimin e rezultatit të vendimit, por ato lehtë mund të manipulohen.	Gjuhë e paqartë dhe me dykuptimësi ekzistojnë disa rregulla ose vendime gjyqësore që ndihmojnë interpretimin.	Tekstet legjislativ janë të shkruara në gjuhë të qartë dhe precize, të kuptueshme vetëm nga profesionistët.	Tekstet legjislativ janë të shkruara në gjuhë të qartë dhe precize, të kuptueshme nga profesionistët dhe qytetarët e rëndomtë.	2	1	2
	2a.5	Kapaciteti për zbatim	Burimet njerëzore dhe financiare janë të pamjaftueshme për të zbatuar kornizën legjislativ.	Burimet njerëzore dhe financiare janë të pamjaftueshme për të zbatuar kornizën legjislativ, por mund të përmirësohen brenda disa vitesh (+5 vite) përmes ngritjes së kapaciteteve.	Burimet njerëzore dhe financiare janë të pamjaftueshme për të zbatuar kornizën legjislativ, por realisht mund të përmirësohen brenda disa vitesh (2-3 vite) përmes ngritjes së kapaciteteve.	Burimet njerëzore dhe financiare pothuaj se të mjaftueshme.	Burimet njerëzore dhe financiare janë të mjaftueshme për të zbatuar me sukses kornizën legjislativ në këtë fushë.	1	1	1
Hapësira publike: Aspektet teknike	2b.1	Mekanizmat për ndarjen e hapësirës adekuate për rrugët (% e tokës, numri i kryqëzimeve, gjerësia dhe gjatësia, dendësia e rrugëve, ekzistenca e planeve rrugore etj.)	Nuk ekziston asnjë mekanizëm.	Mekanizmat ekzistojnë por nuk sigurojnë një furnizim adekuat të hapësirës publike.	Mekanizmat ekzistojnë por sigurojnë një furnizim adekuat të hapësirës publike vetëm në disa pjesë të qyteteve.	Ekzistojnë mekanizma për të siguruar një furnizim adekuat të hapësirës publike për të gjitha pjesët e qyteteve.	Ekzistojnë mekanizma për të siguruar një furnizim adekuat të hapësirës publike për të gjitha pjesët e qyteteve, duke marrë parasysh nevojat lokale dhe ndikimin e kësaj kërkesë në banimin e përballueshëm.	2	1	2
	2b.2	Mekanizmat për ndarjen e hapësirës adekuate për hapësirat publike jo-rrugore (zona të gjelbra, kënde të lojërave, objekte sportive, objekte publike etj.)	Nuk ekziston asnjë mekanizëm.	Ekzistojnë mekanizma për alokimin e hapësirës adekuate për hapësirën publike jo-rrugore, por ato nuk janë të ndjeshme ndaj rezultatit.	Mekanizmat ekzistojnë dhe funksionojnë për alokimin e një sasive adekuate të hapësirës për hapësirën publike jo-rrugore.	Mekanizmat ekzistojnë dhe funksionojnë për alokimin e një sasive adekuate dhe për shpërndarjen e hapësirës për hapësirën publike jo-rrugore.	Mekanizmat ekzistojnë dhe funksionojnë për alokimin e një sasive adekuate dhe për shpërndarjen e hapësirës për hapësirën publike jo-rrugore në të gjitha nivelet (nga masterplani i qytetit tek planet më të detajuara).	1	1	1
	2b.3	Blerja e tokës për hapësirë publike	Mjeti i vetëm në dispozicion për të krijuar hapësirë publike është shpronësimi.	Toka është kontribut i pronarëve të tokës në procesin e urbanizimit/nën-ndarjes së tokës. Kërkesat janë shumë të paqarta dhe lënë hapësirë për diskrecion gjatë aprovimit.	Toka është kontribut i pronarëve të tokës në procesin e urbanizimit/nën-ndarjes së tokës. Kërkesat janë joadekuate ose nuk ndiqen.	Toka është kontribut i pronarëve të tokës në procesin e urbanizimit të tokës. Të drejtat për nën-ndarje ose ndërtim kushtëzohen nga kontributi i tokës.	Toka është kontribut i pronarëve të tokës në procesin e urbanizimit të tokës. Të drejtat për nën-ndarje ose ndërtim kushtëzohen nga kontributi i tokës. Pasi të miratohet plani i rrugës, asnjë ndërtesë nuk mund të ndërtohet ose kompensohet. Lejohet përdorimi i përkohshëm publik i hapësirave boshe.	0	1	0
	2b.4	Standardet e planifikimit për hapësirën publike	Nuk ka standarde të planifikimit për hapësirën publike	Standardet e planifikimit për hapësirën publike ekzistojnë por nuk ofrojnë hapësira publike gjallëruese, të sigurta dhe të qasshme.	Rregulloret marrin parasysh klimën dhe sigurinë, por nuk ofrojnë hapësira publike gjallëruese, të sigurta dhe të qasshme.	Rregulloret marrin parasysh klimën, sigurinë, ofrojnë hapësira publike gjallëruese, të sigurta dhe të qasshme.	Rregulloret marrin parasysh klimën, sigurinë, sigurojnë hapësira vibrante, të sigurta dhe të qasshme publike për gratë, fëmijët, personat me aftësi të kufizuara dhe shitësit joformalë.	0	1	0
	2b.5	Menaxhimi i rrugëve dhe hapësirave publike	Përgjegjësia për menaxhimin e hapësirës publike është shumë e paqartë dhe/ose e fragmentuar ndërmjet institucioneve të ndryshme.	Role dhe përgjegjësi të qarta, por mirëmbajtje e dobët për shkak të mungesës së financimit dhe kuadrove adekuate.	Koordinimi i mirë si dhe financim dhe kuadro adekuate. Hapësira publike mirëmbahet në mënyrë të duhur mirëpo qasja në të është e kufizuar vetëm për qytetarët ose është me pagese.	Role dhe përgjegjësi të qarta, koordinim i mirë si dhe financim dhe kuadro adekuate. Hapësira publike mirëmbahet siç duhet dhe është e hapur për qytetarët.	Role dhe përgjegjësi të qarta, koordinimi i mirë, financimi dhe personeli adekuat. Hapësira publike mirëmbahet siç duhet, është vibrante, e sigurt, e qasshme dhe e hapur për qytetarët. Qytetarët marrin pjesë në menaxhimin dhe përdorimin e tyre.	1	1	1
							Efektiviteti funksional legjislativ:	9		
							Aspektet teknike:	4		
							Rezultati i përgjithshëm:	13		

3: Parcelat dhe blloqet

Treguesi	Nën-treguesi	Renditja					Rezultati/p ikët	Pesha	Totali i pikëve	
		0	1	2	3	4				
Efektiviteti funksional legjislativ	3a.1	Konsistenca e objektivave të politikës	Korniza rregullative në këtë fushë nuk ka politika dhe nuk ka objektiva të qarta.	Ekzistojnë politika jo-konsistente si dhe ligjet kanë objektiva të ndryshme të politikave.	Ekzistojnë politika konsistente në këtë fushë por rregulloret kanë objektiva të ndryshme.	Masat rregullatore në këtë fushë kanë objektiva konsistente.	Masat rregullatore në këtë fushë kanë objektiva konsistente të bazuara në politika të qarta.	3	1	3
	3a.2	Transparenca dhe efikasiteti i mekanizmave dhe proceseve	Procesi i komplikuar dhe burokratik, ku si rezultat vendimi lihet plotësisht në diskrecion të zyrtarëve publik.	Proces kompleks dhe jo-transparent. Ekzistojnë disa rregulla për orientimin e rezultatit të vendimit, por ato lehtë mund të manipulohen.	Proceset janë të përcaktuara në mënyrë të qartë me një shkallë të mjaftueshme të diskrecionit, por nuk funksion mekanizmi i kontrollit dhe balancës (p.sh. miratimi hierarkik nga institucionet e ndryshme, pjesëmarrja publike, konsultimi, apelimi tek gjykata etj.)	Proceset janë të përcaktuara në mënyrë të qartë me një shkallë të mjaftueshme të diskrecionit. Funksionojnë mekanizmat e kontrollit dhe balancës (p.sh. miratimi hierarkik nga institucionet e ndryshme, pjesëmarrja publike, konsultimi, apelimi tek gjykata etj.)	Proceset janë përcaktuar në mënyrë të qartë dhe plotësisht transparente në mënyrë që rezultati i vendimit të mos përfshij asnjë diskrecion.	2	1	2
	3a.3	Organizimi i përgjegjësive dhe roleve institucionale	Disa institucione kanë përgjegjësi për zbatimin e rregulloreve, dhe nuk ka mekanizëm bashkërendues.	Disa institucione kanë përgjegjësi për zbatimin e rregulloreve. Ekzistojnë mekanizmat e bashkërendimit, por nuk funksionojnë.	Disa institucione kanë përgjegjësi për zbatimin e rregulloreve. Ekzistojnë mekanizmat e koordinimit, por funksionojnë me raste.	Rolet dhe përgjegjësitë institucionale në këtë sektor janë të koncentruara në një institucion që jo gjithmonë punon në mënyrë efikase.	Rolet dhe përgjegjësitë institucionale në këtë sektor janë të koncentruara në një institucion efikas ose tek disa institucione të mirë-koordinuara.	3	1	3
	3a.4	Qartësia në standardin e hartimit	Gjuhë jashtëzakonisht e paqartë dhe me dykuptimësi, ku interpretimi lihet plotësisht në diskrecion të zyrtarëve publik.	Gjuhë e paqartë dhe me dykuptimësi ku ekzistojnë disa rregulla ose vendime gjyqësore për orientimin e rezultatit të vendimit, por ato lehtë mund të manipulohen.	Gjuhë e paqartë dhe me dykuptimësi ku ekzistojnë disa rregulla ose vendime gjyqësore që ndihmojnë interpretimin.	Tekstet legjislativ janë të shkruara në gjuhë të qartë dhe precize, të kuptueshme vetëm nga profesionistët.	Tekstet legjislativ janë të shkruara në gjuhë të qartë dhe precize, të kuptueshme nga profesionistët dhe qytetarët e rëndomtë.	1	1	1
	3a.5	Kapaciteti për zbatim	Burimet njerëzore dhe financiare janë të pamjaftueshme për të zbatuar kornizën legjislativ.	Burimet njerëzore dhe financiare janë të pamjaftueshme për të zbatuar kornizën legjislativ, por mund të përmirësohen brenda disa vitesh (+5 vite) përmes ngritjes së kapaciteteve.	Burimet njerëzore dhe financiare janë të pamjaftueshme për të zbatuar kornizën legjislativ, por realisht mund të përmirësohen brenda disa vitesh (2-3 vite) përmes ngritjes së kapaciteteve.	Burimet njerëzore dhe financiare pothuaj se të mjaftueshme.	Burimet njerëzore dhe financiare janë të mjaftueshme për të zbatuar me sukses kornizën legjislativ në këtë fushë.	2	1	2
Parcelat dhe blloqet: aspektet teknike	3b.1	Fleksibiliteti në madhësinë e parcelës që mundëson diversifikimin për përdorime të ndryshme të tokës dhe përballueshmërinë	Madhësia minimale e parcelës është 801 m ² - ose më shumë. Parcelat me përmasa më të vogla nuk mund të krijohen ligjërisht.	Madhësia minimale e parcelës është midis 501-800 m ² . Parcelat me përmasa më të vogla nuk mund të krijohen ligjërisht.	Madhësia minimale e parcelës është midis 301-500 m ² . Parcelat me përmasa më të vogla nuk mund të krijohen ligjërisht.	Madhësia minimale e parcelës është midis 101-300 m ² . Parcelat me përmasa më të vogla nuk mund të krijohen ligjërisht.	Madhësia minimale e parcelës është 20-100 m ² , apo nuk ka fare madhësi minimale. Parcela me përmasa më të mëdha mund të krijohen nëse është e nevojshme.	3	1	3
	3b.2	Gjatësia maksimale e bllokut në çdo drejtim (kryesisht për përdorim rezidencial/të përzier të tokës, me përjashtim të përdorimeve industriale dhe përdorimeve tjera që kërkojnë blloqe më të mëdha)	Nuk ka kritere.	Më shumë se 400 m.	300-200 m.	200-130 m.	Më pak se 130 m.	0	1	0
	3b.3	Nënndarja e tokës në parcela urbane (nënndarja e tokës bujqësore)	Nuk ekziston asnjë mekanizëm, por edhe nëse ekziston ndonjë, nuk ka rregulla për të administruar nënndarjen.	Proces i gjatë dhe i kushtueshëm. Rregulla shumë të paqarta për t'u ndjekur. Nënndarja bëhet nga pronari privat me aprovim publik (shumë diskrecional).	Proces i gjatë dhe i kushtueshëm. Rregullat për t'u ndjekur janë të qarta, por standardet e nënndarjes nuk janë adekuate. Nënndarja bëhet nga pronari privat me aprovim publik.	Nënndarja mund të propozohet nga autoritetet publike në konsultim me pronarët. Ekziston një tregues i qartë i formave të parcelave me standardet e kërkuara urbane për hapësirën publike, rrugët dhe objektet e tjera.	E lehtë dhe e drejtpërdrejtë, me tregues të qartë të formave të parcelave dhe standardeve të kërkuara urbane për hapësirën publike, rrugët dhe objektet tjera. Zhvillimi i standardeve dhe infrastrukturës së kërkuar mbulohet nga pronari.	1	1	1
	3b.4	Konsolidimi i parcelave (ngastrat ngjitur të pronarëve të njëjtë ose të ndryshëm)	Nuk ekziston asnjë mekanizëm, por edhe nëse ekziston ndonjë, nuk ka rregulla për të orientuar konsolidimin.	Ekziston një mekanizëm për konsolidimin por kërkon një proces kompleks dhe të shtrenjtë. Rregullat për t'u ndjekur janë të paqarta. Miratimi i tij është shumë diskrecional.	Proces i gjatë dhe i kushtueshëm. Standardet nuk janë adekuate. Përshtatshmëria e infrastrukturës ekzistuese nuk merret fare parasysh.	Proces i thjeshtë dhe i drejtpërdrejtë. Konsolidimi përdoret për të rritur densitetin në zonat urbane që tashmë janë të servisuara (të mbushura) dhe është pjesë e politikës dhe programeve urbane.	I thjeshtë dhe i drejtpërdrejtë. Konsolidimi përdoret për të rritur densitetin në zonat urbane që tashmë janë të servisuara (të mbushura) dhe është pjesë e politikës dhe programeve urbane. Ekzistenca e stimujve (p.sh. lejohet e drejta e refuzimit të parë për fqinjët, densiteti mi i madh etj.)	3	1	3
